FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Nr.183 22 dhjetor 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1555, datë 12.11.2008	Për përcaktimin e rregullave të regjistrimit dhe të kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve……	9093
Vendim i KM nr.1561, datë 3.10.2008	Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale, për parandalimin e luftën kundër korrupsionit dhe për një qeverisje transparente, 2008-2013 ……	9109
Vendim i KM nr.1562, datë 26.11.2008	Për një shtesë në vendimin nr.108, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Fushë-Krujë, të qarkut të Durrësit".	9126
Vendim i KM nr.1563, datë 26.11.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Kavajë, të qarkut të Tiranës ……..	9128
Vendim i KM nr.1564, datë 26.11.2008	Për një shtesë në vendimin nr.202, datë 21.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Thumanë, të qarkut të Durrësit"..	9129
Vendim i KM nr.1565, datë 26.11.2008	Për një shtesë në vendimin nr.107, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Krujë, të qarkut të Durrësit" …….	9131
Vendim i KM nr.1567, datë 26.11.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Nikël, të qarkut të Durrësit ……	9133

VENDIM
Nr.1555, datë 12.11.2008

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË REGJISTRIMIT DHE TË KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË PRODUKTEVE PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.9362, datë 24.3.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME, PËRKUFIZIME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave dhe i kërkesave për:

a) regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB), në formën e tyre tregtare, që do të importohen dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) regjistrimin e lëndëve vepruese dhe të përbërësve të tjerë, që përmbajnë PMB-të, kjo në funksion të mbrojtjes së bimëve e të produkteve bimore nga parazitët, njëkohësisht pa ndikime në shëndetin e njerëzve, të kafshëve dhe në mjedis.

2. PMB-të nuk mund të futen në treg dhe të përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përveçse në rastet kur janë të regjistruara, në përputhje me këtë vendim.

3. Kur një PMB nuk është regjistruar për t'u përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk duhet të ndalohet prodhimi, magazinimi dhe tranzitimi i këtij produkti për në një vend tjetër, me kusht që:

a) PMB-ja të jetë e regjistruar për t'u përdorur në atë vend;

b) prodhimi, magazinimi dhe tranzitimi të jenë rreptësisht të kontrolluara nga strukturat përkatëse shtetërore.

4. Lëndët vepruese nuk mund të futen në treg dhe të përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përveçse në rastet kur janë të regjistruara, në përputhje me këtë vendim.

5. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

5.1 "Lëndë (substanca)", elementet kimike dhe përbërësit e tyre, në gjendjen natyrale ose të përftuara nëpërmjet çfarëdo procedure prodhimi, përfshirë shtuesit e nevojshëm, për të ruajtur qëndrueshmërinë e produktit dhe papastërtitë e rrjedhura nga fabrikimi, përjashtuar tretësit, që mund të ndahen pa ndikuar në qëndrueshmërinë e substancës ose modifikuar përbërjen. Një substancë mund të jetë e përcaktuar qartë kimikisht (p.sh. acetoni) ose të konsistojë në një përzierje komplekse përbërësish, me kompozim të ndryshëm (p.sh., distilatet aromatike). Në këtë rast janë të identifikuar disa përbërës.

5.2 "Lëndë (substancë) vepruese", lënda ose mikroorganizmi, përfshirë viruset, që ka një veprim, specifik ose të përgjithshëm, te organizmat dëmtues a te bimët, në pjesët bimore ose produktet e tyre.

5.3 "Lëndë vepruese teknike", lënda e fabrikuar (prodhuar), që ndodhet në PMB dhe që përmban lëndën vepruese të pastër, së bashku me papastërtitë, brenda kufijve të lejuar.

5.4 "Papastërti", çdo përbërës, të ndryshëm nga lënda vepruese e pastër, i pranishëm në lëndën vepruese të prodhuar (përfshirë izomeret inaktive), që rezulton nga procesi i fabrikimit ose nga degradimi gjatë ruajtjes.

5.5 "Papastërti të spikatura (rëndësishme)", papastërtitë, që kanë rëndësi toksikologjike, ekotoksikologjike dhe/ose mjedisore.

5.6 "Metabolite", produktet, që rezultojnë nga degradimi ose nga reagimet e lëndës vepruese.

5.7 "Metabolite të spikatura", metabolitet, që kanë rëndësi toksikologjike, ekotoksikologjike dhe/ose mjedisore.

5.8 "Kontroll i integruar", përdorimi racional i disa metodave biologjike, bioteknologjike, kimike, kulturore ose të seleksionimit bimor, me anë të të cilave kufizohet, në minimumin e kërkuar, përdorimi i PMB-ve, për të mbajtur parazitët në nivele më të ulëta se ato, që provokojnë dëme ose

humbje, ekonomikisht të papranueshme.

5.9 “Lëndë vepruese e re”, lënda vepruese, e cila nuk është e përfshirë në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe, sipas rregullave ndërkombëtare, prodhimi i saj është patentë e një subjekti të caktuar.

5.10 “Lëndë vepruese e vjetër”, lënda vepruese, e cila nuk është përfshirë në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe, sipas rregullave ndërkombëtare, patenta e prodhimit të saj është e hapur (produkt xhenerik).

5.11 “CAS NR”, një sigël, që identifikon një lëndë vepruese.

5.12 “Emri kimik i lëndës vepruese”, emri shkencor i lëndës vepruese (IUPAC, CA), në përmbajtje të PMB-së, që tregon formulën lineare të saj.

5.13 “Emri i zakonshëm i lëndës vepruese”, emërtimi i lëndës vepruese në përmbajtje të PMB-së, i përcaktuar nga një ose më shumë organizata shkencore ndërkombëtare (ISO, BAN, BSI, ESA, JMAF, WSSA), që tregohet gjatë regjistrimit të PMB-së.

5.14 “Preparat (produkt)”, përzierja ose tretësira, e përbërë nga dy ose më shumë lëndë, ku të paktën njëra prej tyre është lëndë vepruese, e destinuar për t’u përdorur si PMB.

5.15 “Emër tregtar i PMB-së”, emri, me të cilin PMB-ja është e propozuar nga aplikanti i saj, dhe me të cilin ajo regjistrohet, etiketohet dhe ambalazhohet.

5.16 “Formulim”, një përzierje e lëndës/ve vepruese me shtues të caktuar (ngjitës, lagës, emulsionues, pezullues, tretës etj.). Në bazë të këtyre shtuesve përcaktohen edhe llojet (kodet) e formulimeve të PMB-ve, sipas shtojcës VIII, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.17 “Pajtueshmëri e PMB-së”, mundësia e bashkimit të dy ose më shumë PMB-ve gjatë trajtimit, por pa shkaktuar fitotoksicitet te bimët që trajtohen. Zakonisht kjo pasqyrohet në dokumentacionin e PMB-së që regjistrohet.

5.18 “Tërheqës dhe vrasës”, një kurth, të përbërë nga një fenomon dhe një insekticid kontakti, në sasi të vogël, që përdoret, kryesisht, në programet e integruara të luftimit të dëmtuesve.

5.19 “Tërheqës seksual”, lëndë me erë karakteristike për femrat e dëmtuesit, që luftohet, e cila përdoret për tërheqjen e meshkujve në “kurthe seksuale”. Përdoret kryesisht në programet e integruara të luftimit të dëmtuesve, si dhe në monitorimin e tyre.

5.20 “LD 50”, sasia e lëndës vepruese, në përmbajtje të PMB-së, e futur menjëherë në organizmin e minjve në laborator, e mjaftueshme për të shkaktuar ngordhjen e 50% të individëve. Shprehet në mg lëndë vepruese/një kilogram minj, të vënë në provë.

5.21 “CL 50”, përqendrimi i lëndës vepruese në përmbajtje të PMB-së (në ujë ose ajër), e cila shkakton ngordhjen e 50% të minjve, të vënë në provë. Shprehet në njësi/milion.

5.22 “Toksicitet akut”, intoksikimi (helmimi), që vërehet brenda një kohe të shkurtër, nga çasti kur lënda vepruese është gëlltitur, thithur ose marrë nëpërmjet lëkurës.

5.23 “Toksicitet kronik”, intoksikimi (helmimi), që vërehet pas një kohe të caktuar, duke sjellë grumbullim gradual të lëndës vepruese në një ose disa organe.

5.24 “Toksicitet dermal”, intoksikimi (helmimi) nga marrja e një lënde vepruese, nëpërmjet lëkurës. Vlerësohet duke njohur LD 50 dermale të lëndës vepruese në shqyrtim.

5.25 “Toksicitet oral”, intoksikimi (helmimi) nga marrja e një lënde vepruese, nëpërmjet gëlltitjes nga goja. Vlerësohet duke njohur LD 50 orale të lëndës vepruese në shqyrtim.

5.26 “Toksicitet me frymëmarrje”, intoksikimi (helmimi) nga marrja e një lënde vepruese, nëpërmjet rrugëve të frymëmarrjes. Vlerësohet duke njohur CL 50 të lëndës vepruese në shqyrtim.

5.27 “AOEL (Acceptable operator exposure level) - niveli i pranueshëm i ekspozimit të përdoruesit”, sasia e lëndës vepruese në përmbajtje të PMB-së, ndaj të cilit përdoruesi është i ekspozuar.

5.28 “NOEL (No observed effect level)-nivel efekti i pavëzhguar”, doza më e lartë e një lënde vepruese në përmbajtje të PMB-së, e përdorur në provë te minjtë, që nuk shkakton ndonjë dëmtim.

5.29 “ADI (Acceptable daily intake) - doza ditore e pranueshme”, doza ditore e PMB-së, e pranueshme për njeriun. Vlerësohet duke përdorur vlerën më të ulët të NOEL-it, e shprehur në mg/kg/ditë.

5.30 “TMDI (Theoretical maximum daily intake) - doza teorike maksimale ditore”, vlerësimi i sasisë maksimale ditore të mbetjes, që merret nga njeriu. Bazohet te vlerat e dietës mesatare ditore dhe te MML-të e përcaktuara për kulturën bujqësore.

5.31 “Periudha e sigurisë”, intervali kohor, i shprehur në ditë, ndërmjet trajtimit të fundit dhe vjeljes, ndërsa për produktet e magazinuara, ndërmjet trajtimit të fundit dhe hedhjes në treg.

5.32 “Periudha e rihyrjes”, intervali kohor, i shprehur në ditë, nga çasti i kryerjes së trajtimit deri në atë kur punëtori mund të hyjë në mjedisin ose zonën e trajtuar, pa përdorur mjete mbrojtëse individuale.

5.33. “ML (Mbetje maksimale e lejueshme)”, niveli më i lartë i lejuar, i përqendrimit të mbetjeve të lëndës vepruese në përmbajtje të një PMB-je, në produktet e ngrënshme për njerëz apo kafshë, i cili përcaktohet në bazë të:

a) rekomandimeve të Komisionit Europian;

b) praktikave të mira bujqësore;

c) nivelit më të ulët të ekspozimit, ndaj të cilit është i mbrojtur edhe konsumatori më i ndjeshëm;

ç) minimumit të nevojshëm të ekspozimit të konsumatorit.

5.34 “Monografia për një PMB ose lëndë vepruese”, raporti që kryhet në bazë të vlerësimeve të PMB-ve, nga institutet e vlerësimit dhe që shërben për të përgatitur raportin përmbledhës për KSHRPMB-në.

5.35 “PMB me natyrë inorganike”, PMB-ja, që ka në përmbajtje lëndë vepruese, si:

a) komponime inorganike të bakrit: oksikloruri i bakrit, hidroksidi i bakrit, oksidi i bakrit, pasta bordoleze (gur kali + gëlqere), e të tjera;

b) komponime inorganike të squfurit mineral;

c) komponime të tjera inorganike të hekurit (p.sh., sulfati i hekurit), të kaliumit (p.sh., permanganati i kaliumit).

5.36 “PMB identike me PMB-të e regjistruara”, PMB-ja, që:

a) ka origjinë nga i njëjti prodhues ose një shoqëri e asociuar;

b) përmban të njëjtat lëndë vepruese e sasi, me të njëjtin minimum respektiv të pastërtisë, dhe të njëjtat papastërti e sasi, me të njëjtin maksimum të përmbajtjes së tyre;

c) është identik në përbërësit e formulimit, në etiketë dhe ambalazhim, por ka emër tregtar të ndryshëm.

5.37 “SPMB”, struktura përgjegjëse për mbrojtjen e bimëve.

5.38 “KSHRPMB”, komisioni shtetëror për regjistrimin e PMB-ve.

5.39 “Kërkues ose aplikant”, personi apo subjekti, që fabrikon një PMB ose lëndë vepruese ose që ia beson fabrikimin e tyre një të treti, apo një personi të emëruar nga fabrikuesi, si përfaqësues i tij ekskluziv, për regjistrimin e PMB-së ose të lëndës vepruese.

5.40 “Mjedis”, uji (përfshirë dhe ujërat nëntokësore), ajri, toka, speciet e egra të florës e të faunës dhe ndërveprimet ndërmjet tyre, si dhe ndërveprimet ndërmjet organizmave të gjalla.

II. KRITERET E VLERËSIMIT TË PMB-VE, KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR REGJISTRIMIN E NJË PMB-JE

1. Të gjitha proceduarat, që lidhen me regjistrimin e një PMB-je dhe/ose të një lënde vepruese, si dhe të shtuesve e të bashkëvepruesve, drejtohen nga ministria, që mbulon fushën e bujqësisë, nëpërmjet SPMB-së, si autoriteti përgjegjës.

2. Komisioni shtetëror i regjistrimit të PMB-ve (KSHRPMB), i ngritur pranë SPMB-së, në ministrinë, që mbulon fushën e bujqësisë, përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë vijon:

a) 1 (një) përfaqësues nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve, në ministrinë, që mbulon fushën e bujqësisë;

b) 1 (një) përfaqësues (mjek higjienist), nga ministria, që mbulon fushën e shëndetësisë;

c) 1 (një) përfaqësues (ekspert i mjedisit), nga ministria, që mbulon fushën e mjedisit;

ç) 1 (një) përfaqësues (ekspert i sigurisë në punë), nga ministria, që mbulon fushën e sigurisë në punë;

d) 1 (një) kimist analist, nga Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);

dh) 1 (një) specialist, nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV);

e) 1 (një) pedagog i mbrojtjes së bimëve, nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.

2.1 Lista emërore e anëtarëve të komisionit miratohet me urdhër të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë, pas propozimit të bërë nga institucionet përkatëse.

2.2 Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi në fushën e PMB-ve. Ata,

paraprakisht, duhet të deklarojnë marrëdhëniet, nëse kanë, me subjektet e importimit ose të tregtimit të PMB-ve.

2.3 Komisioni shërben si organ këshillimor, funksionimi i të cilit rregullohet me urdhër të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë.

3. Ministria, që mbulon fushën e shëndetësisë, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), bën vlerësimin e PMB-ve, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për studimet toksikologjike të tyre, të lëndës vepruese dhe të përbërësve të tjerë, për informacionin plotësues, për simbolet, frazat e rrezikut e të sigurisë), si dhe përgatit raportin vlerësues të tyre, në kuadër të:

a) shëndetit të njerëzve, toksicitetit dhe neurotoksicitetit në njerëz (toksicitetit akut dhe kronik; ndjeshmërisë së lëkurës, të syve dhe të frymëmarrjes; toksicitetit riprodhues);

b) thithjes, shpërndarjes dhe nxjerrjes jashtë trupit (për marrjen nga goja e lëkura);

c) higjienës ushqimore, veçanërisht klasifikimit për nga vetitë, që shfaqin për rrezikshmërinë ndaj njerëzve;

ç) karencës (PHI) dhe periudhës së rihyrjes në mjedisin ose në parcelën e trajtuar dhe të masave të tjera, për mbrojtjen e njerëzve;

d) veshjeve mbrojtëse të nevojshme;

dh) masave, për ndihmën e shpejtë në rast helmimi, këshillave për mjekun, të terapisë dhe të antidoteve.

4. Ministria, që mbulon fushën e mjedisit, bën vlerësimin e PMB-ve, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për informacionin e mëtejshëm për PMB-në, për rrezikun dhe veprimin mjedisor, studimet ekotoksikologjike, si dhe përgatit raportin vlerësues të tyre, në kuadër të:

a) sjelljes në mjedis (përhapja dhe shpërndarja në tokë, në ujë dhe në ajër);

b) ndikimeve dhe mbrojtjes së mjedisit;

c) kushteve të përdorimit për mbrojtjen e mjedisit;

ç) klasifikimit për rrezikun ndaj mjedisit;

d) identitetit të produkteve të djegies në rast zjarri;

dh) procedurave të asgjësimit të PMB-ve dhe ambalazhit të tyre;

e) mundësisë së neutralizimit;

ë) rrezikut në rastet e përdorimit pranë/rreth sipërfaqeve ujore.

5. Ministria, që mbulon fushën e bujqësisë, nëpërmjet Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), bën vlerësimin e PMB-ve, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për veçoritë fizike, kimike e teknike të tyre dhe të lëndës vepruese, për metodat analitike të PMB-së dhe të lëndës vepruese, për mbetjet në/ose mbi produktet e trajtuara, ushqimin e njerëzve e të kafshëve, të PMB-së dhe të lëndës vepruese, për informacionin plotësues për MML-të, si dhe përgatit raportin vlerësues të tyre, në bazë të:

a) vetive fizike, kimike e teknike të PMB-ve dhe të lëndëve vepruese;

b) përbërjeve, sasiore dhe cilësore, të PMB-ve (lënda/lëndët vepruese, papastërtitë, shtuesit, përbërësit inerte etj.);

c) toksicitetit dhe neurotoksicitetit në blegtori dhe kafshët shtëpiake (toksiciteti akut dhe kronik; toksiciteti riprodhues);

ç) periudhës së rihyrjes në mjedisin ose në parcelën e trajtuar dhe të masave të tjera, për mbrojtjen e blegtorisë e të kafshëve shtëpiake;

d) mbetjeve në produktet e trajtuara, që shërbejnë si ushqim për njerëzit dhe për blegtorinë;

dh) përcaktimit të mbetjeve maksimale të lejueshme (MML) në bimë e produkte bimore;

e) periudhës së ruajtjes dhe të magazinimit, për përdorimin pas vjeljes;

ë) vetive ekotoksikologjike (efektet te zogjtë, organizmat ujorë, bletët, krimbat e tokës dhe mikroorganizmat e tokës, që nuk janë objekt i luftimit);

f) metodave të rekomanduara dhe të kushteve paraprake për mbajtjen, magazinimin, transportin e mbrojtjen nga zjarri;

g) qëndrueshmërisë në ruajtje (efektet e dritës, temperaturës dhe lagështisë në karakteristikat e PMB-ve);

gj) metodave të përdorura për përcaktimin e PMB-së, të lëndës/ve vepruese teknike dhe të pastra, të papastërtive, të mbetjeve në ushqimet për njerëz e për kafshë;

h) ambalazhimit (lloji, materialet përbërëse, madhësia etj.).

6. Ministria, që mbulon fushën e arsimit dhe të shkencës, nëpërmjet Departamentit të

Mbrojtjes së Bimëve (DMB), pranë UB, Tiranë, bën vlerësimin e PMB-ve sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të dhënat për përdorimin, për të dhënat për efikasitetin, si dhe përgatit raportin vlerësues të tyre, në bazë të:

a) të dhënave për përdorimin (fusha e përdorimit, mënyra e veprimit ndaj parazitëve);

b) kushteve specifike, agroteknike dhe mjedisore, në të cilat mund të përdoret ose jo;

c) mënyrës dhe dozës së rekomanduar të përdorimit;

ç) numrit të trajtimeve, kohës së trajtimit dhe zgjatjes së efektit mbrojtës;

d) mundësisë së shfaqjes dhe zhvillimit të rezistencës e parazitët, ku përdoret;

dh) efektit në cilësinë dhe rendimentin e kulturave të trajtuara;

e) fitotoksicitetit për bimët, që trajtohen, (përfshirë dhe kultivarët e ndryshëm të tyre);

ë) efekteve anësore të padëshiruara (tek organizmat e dobishëm dhe ato që nuk janë objekt i luftimit, te kulturat pasardhëse etj.).

7. Një PMB regjistrohet, nëse përmbush kërkesat e mëposhtme:

7.1 Është e regjistruar në dy shtete anëtare të BE-së ose në një nga shtetet mesdhetare a ballkanike të BE-së, që kanë kushte klimatike, agroteknike dhe mjedisore, të krahasueshme me vendin tonë.

7.2 Lënda/lëndët vepruese të saj, si dhe shtuesit e bashkëvepruesit, janë përfshirë në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kushtet e përcaktuara në pikat vijuese, nga 7.3 deri në 7.8 të këtij kreu, janë të kënaqshme dhe në zbatim të parimeve uniformë, të përshkruara në shtojcën VII, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7.3 Vlerësimi të bëhet në bazë të njohurive bashkëkohore tekniko-shkencore dhe në bazë të përmbajtjes e të vlerësimit të dosjes së regjistrimit, si dhe duke pasur parasysh të gjitha kushtet normale të përdorimit dhe pasojat nga përdorimi.

Një PMB e tillë duhet:

a) të jetë mjaftueshmërisht efektive për luftimin e organizmave të dëmshëm, të përcaktuar në dosjen e PMB-së;

b) të mos ketë efekte të papranueshme (të dëmshme) në bimët apo produktet bimore, ku përdoret;

c) të mos shkaktojë vuajtje dhe dhimbje të papranueshme te vertebrorët, që i lufton;

ç) të mos ketë efekt të dëmshëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi shëndetin e njerëzve apo të kafshëve, që e marrin atë nëpërmjet ujit të pijshëm a ushqimit, ose tek ujërat nëntokësorë;

d) të mos ketë ndikim të papranueshëm mbi mjedisin, përsa i përket, veçanërisht:

i) fatit të tij dhe shpërndarjes në mjedis, me referim të veçantë në ndotjen e ujërave, përfshirë edhe ujin e pijshëm dhe ujërat freatike;

ii) ndikimit mbi speciet e bimëve e të kafshëve, që nuk janë objekt trajtimi;

dh) të plotësohen kërkesat për paketimin dhe etiketimin e tij.

7.4 Vetitë fiziko-kimike të PMB-së të jenë të pranueshme për qëllimin e përdorimit dhe të magazinimit.

7.5 Natyra dhe cilësia e të gjitha lëndëve vepruese, që përmbahen në një PMB, mund të përcaktohen me metodën e duhur. Metoda e duhur është ajo që referohet në shtojcën I, që i basbkëlidhet këtij vendimi.

7.6 Çdo papastërti, toksike ose ekologjikisht e dëmshme, që përmban një PMB, mund të përcaktohet me metodën e duhur. Metoda e duhur është ajo, që referohet në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7.7 Mbetjet në tokë, ujë, bimë ose produkt bimor, që mund të vijnë nga përdorimi i një PMB-je të regjistruar, mund të përcaktohen me metodën e duhur. Metoda e duhur është ajo, që referohet në shtojcën I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7.8 Niveli maksimal i mbetjeve të një lënde vepruese ose të një lënde, që lidhet me të, i cili mund të rezultojë nga përdorimi i autorizuar, është më i vogël ose i barabartë me nivelin maksimal të lejuar.

Në veçanti:

a) Nuk mund të ndalohet apo të pengohet hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e produkteve, me përmbajtje mbetjesh të PMB-ve, nëse niveli i mbetjeve nuk kalon nivelet maksimale të

përkohshme, të stabilizuara;

b) Duhet të garantohet që kushtet për regjistrim të jenë të zbatueshme në mënyrë të tillë, që të shmangen tejkalimet e niveleve maksimale, të përkohshme.

7.9 Mbetjet e bimëve apo të produkteve bimore, që përdoren si ushqim për kafshët ose për njerëzit, të mos tejkalojnë kufijtë e lejuar.

7.10 Të plotësojë standardet sipas specifikimeve të FAO-s për produktet e mbrojtjes së bimëve.

7.11 Të mos emërtohet me një emër tregtar, i cili:

a) i korrespondon emrit tregtar të një PMB-je, të regjistruar më parë;

b) mund të çojë në konfuzion ose mashtrim për efektin dhe vetitë e një PMB-je.

7.12 Regjistrimi duhet të saktësojë kërkesat e tregtimit e të përdorimit të PMB-së dhe, të paktën, ato të nevojshmet, për të qenë në rregull me kërkesat e pikës 7.3 të këtij kreu.

7.13 SPMB-ja merr masa, që përputhja me kërkesat e përcaktuara në pikat 7.5 deri në pikën 7.9 të këtij kreu, të jetë qartësuar, nëpërmjet provash e kontrollesh zyrtare, ose të jenë zyrtarisht të njohura, sipas kushteve bujqësore, fitosanitare e mjedisore, për të qenë të përshtatura për përdonimin e PMB-së në fjalë.

III. REGJISTRIMI E ÇREGJISTRIMI I LËNDËVE VEPRUESE

1. SPMB-ja regjistron çdo lëndë vepruese, pasi të ketë marrë:

a) kërkesën për regjistrimin e saj, në formën, mënyrën dhe kohën e kërkuar;

b) dosjen, që përshkruan karakteristikat e lëndës vepruese, sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Lëndët vepruese, të regjistruara në bazë të informacionit, të siguruar sipas pikës 1 të këtij kreu, do të klasifikohen për një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme:

a) Lëndë vepruese, që mund të përmbahet në një PMB, e cila do të hidhet në treg, me kusht që SPMB-ja të pohojë se:

i) lënda vepruese është e përshtatshme, për qëllimin që do të përdoret;

ii) lënda vepruese nuk ka efekte dëmtuese mbi përdoruesin ose manipuluesin e saj;

iii) mbetjet, që rezultojnë nga përdorimi i kësaj lënde vepruese dhe që mund të gjenden në produktet bimore, janë të sigurta për konsum nga njerëzit apo kafshët;

iv) hedhja në mjedis e çdo mbetjeje të tillë, të lëndës vepruese, nuk sjell efekte të papranueshme në mjedis, përfshirë edhe efektin në biodiversitet.

b) Lëndë vepruese, që nuk lejohet të përmbahet te një PMB, që do të hidhet në treg, me kusht që SPMB-ja të pohojë se kjo lëndë vepruese nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në nënndarjet “i” deri “iv”, të shkronjës “a” të kësaj pike;

c) Lëndë vepruese, që mund të përmbahet te një PMB, e klasifikuar “PMB e rrezikshme” ose “PMB me rrezik të lartë”, që do të hidhet në treg, me kusht që SPMB-ja të pohojë se kjo lëndë vepruese plotëson kërkesat e përcaktuara në nënndarjet “i” deri “iv”, të shkronjës “a” të kësaj pike, por kërkohet përdorimi nga përdorues profesionistë.

3. Çregjistrimi i një lënde vepruese kryhet kur:

a) nuk është e miratuar për t’u futur ose është hequr nga shtojca II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) aplikanti e kërkon, me shkrim, një gjë të tillë;

c) ka përfunduar afati i regjistrimit të saj.

4. Përfshirja e lëndëve vepruese në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për një periudhë deri në 10 vjet, si dhe modifikimet e heqjet e tyre përditësohen, me urdhër të përbashkët të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë, të ministrit, që mbulon fushën e shëndetësisë, si dhe të ministrit, që mbulon fushën e mjedisit, në përputhje me legjislacionin e BE-së.

IV. PËRMBAJTJA E DOSJES SË PMB-SË, APLIKIMI PËR REGJISTRIM

1. Të dhënat, që duhet të përmbajë dokumentacioni i regjistrimit të PMB-së, janë:

a) Një dosje me të dhëna për PMB-në, sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, duke mbajtur parasysh njohuritë aktuale, shkencore dhe teknike;

b) Një dosje me të dhëna, për çdo lëndë vepruese në përmbajtje të PMB-së, sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, duke mbajtur parasysh njohuritë aktuale, shkencore dhe teknike;

c) Dokumentacioni për të dhënat e sigurisë (MSDS).

Në dosje përcaktohen qartë veçanërisht:

a) Emri dhe adresa e fabrikimit të PMB-së;

b) Emri dhe adresa e fabrikimit të lëndës/ve vepruese dhe të përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-së;

c) Përmbajtja e lëndës/ve vepruese teknike dhe niveli i pastërtisë;

ç) Përmbajtja e lëndës/ve vepruese të pastër/ra;

d) Natyra dhe përmbajtja e papastërtive.

2. PMB-të duhet të përmbajnë lëndë vepruese dhe shtues e bashkëveprues, të cilët janë të listuar në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Të dhënat, që duhet të përmbajë dokumentacioni (MSDS), i përmendur në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij kreu, janë sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në veçanti, ky dokumentacion duhet t'i japë punëdhënësit mundësinë të përcaktojë nëse në vendin e punës është i pranishëm ndonjë agjent kimik i rrezikshëm dhe të vlerësojë çdo rrezik për shëndetin e sigurinë e punonjësve, që mund të shfaqet nga përdorimi i tyre. Informacioni duhet të jetë i shkruar qartë dhe në mënyrë të saktë. Në disa raste, duke pasur parasysh shkallën e gjerë të vetive të lëndëve vepruese apo të PMB-ve, mund të jenë të nevojshme të dhëna shtesë. Nëse, në disa raste, del se të dhënat për veti të caktuara janë jo të rëndësishme ose janë teknikisht të pamundura arsyet për këtë duhet të shkruhen qartë nën çdo titull. Të dhënat jepen për çdo veti të rrezikshme. Nëse shkruhet që një rrezik i caktuar nuk shfaqet, duhet të diferencohet qartë ndërmjet rasteve ku, për këtë, nuk ka të dhëna, me rastet kur disponohen rezultatet negative të testeve.

4. Për rreziqet e veçanta, që paraqet PMB-ja ndaj njerëzve, kafshëve dhe mjedisit, si dhe për masat e mbrojtjes përdoren simbole, fraza standarde të rrezikut (*R-Phrases*) e të sigurisë (*S-Phrases*), respektivisht, sipas shtojcave IV, V e VI, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Parimet uniforme për vlerësimin e PMB-ve gjatë regjistrimit janë sipas shtojcës VII, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Kodet e formulimit të PMB-ve janë sipas shtojcës VIII, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Shtojcat I, II, III, IV, V, VI, VII e VIII janë pjesë e këtij vendimi dhe përditësohen me urdhër të përbashkët të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë, të ministrit, që mbulon fushën e shëndetësisë dhe të ministrit, që mbulon fushën e mjedisit, në përputhje me legjislacionin e BE-së.

8. Për fillimin e procedurës së regjistrimit të një PMB-je, aplikanti paraqet, pranë SPMB-së:

a) dosjen e regjistrimit (dokumentacionin e PMB-së), sipas kërkesave të pikës I të këtij kreu;

b) dokumentacionin shoqërues të dosjes së regjistrimit të PMB-së;

c) për kryerjen e analizave cilësore të tyre, kampione të PMB-së, 2 x 250 gr ose ml, të lëndës/ve vepruese, në përmbajtje të PMB-së, 2 x 3 gr ose ml, si dhe të përbërësve të tjerë (sipas numrit të tyre), 2 x 50 gr ose ml;

ç) kampione të PMB-së, për kryerjen e provave (nëse kërkohet) të përdorimit, të toksikologjisë dhe të ekotoksikologjisë, në sasitë sipas metodikave të provave, që do të kryhen nga institucionet zyrtare, të ngarkuara për këtë qëllim;

d) kampionin e ambalazhit bazë, që do të përdoret për PMB-në, si dhe deklaratën e konformitetit të tij.

8.1 Dokumentacioni i PMB-së për regjistrim paraqitet në gjuhën shqipe ose anglisht, ndarë në:

a) një kopje origjinale të dokumentacionit, sipas pikave 8, shkronja "a", e 8.2, të këtij kreu, në dosje dhe në formë elektronike (CD), që mbahet në arkivën e SPMB-së;

b) dokumentacionin, në dosje, sipas përcaktimeve të pikave 2, 3, 4 e 5 të kreut II, i cili dërgohet në institutet e vlerësimit, për t'u shqyrtuar.

8.2 Dokumentacioni shoqërues përfshin:

a) Kërkesën e aplikantit për regjistrimin e PMB-së, në gjuhën shqipe, me nënshkrimin e titullarit dhe vulën e njomë, të pajisur edhe me pullë postare;

b) Certifikatën dhe etiketën e regjistrimit të PMB-së, origjinale ose të noterizuara në vendin/vendet e BE-së, ku është kryer regjistrimi, si dhe të nënshkruara e të vulosura nga titullari, që zotëron PMB-në. Etiketa të jetë në përmasa standarde 210 x 297 mm, e shoqëruar me kopjen në gjuhën shqipe.

9. Sekretaria (Zyra) e regjistrimit të PMB-ve merr në dorëzim dosjen e regjistrimit dhe pasi e shqyrton atë, sipas kërkesave të pikës 8 të këtij kreu, e pranon për ta futur në procedurë regjistrimi. Nëse nuk e pranon, brenda 30 ditëve, vë në dijeni, me shkrim, aplikantin, ku paraqet edhe arsyet e mospranimit ose kërkesat për të dhënat shtesë.

10. Dokumentacioni i PMB-së dorëzohet në institutet e vlerësimit brenda 20 ditëve nga data e pranimit të tij.

11. Institutet e vlerësimit bëjnë vlerësimin e të dhënave të dokumentacionit të PMB-së brenda një periudhe deri në 6 muaj, duke përgatitur, për çdo PMB, monografinë, të cilën ia dërgojnë SPMB-së.

12. Sekretaria (Zyra) e regjistrimit të PMB-ve, në bazë të monografisë për secilën PMB, përgatit materialin përmbledhës për mbledhjen e radhës së KSHRPMB-së.

13. Sekretaria e regjistrimit të PMB-ve, në bazë të materialit përmbledhës dhe të përfundimeve të KSHRPMB-së, përgatit dokumentin e regjistrimit për çdo PMB të miratuar, si dhe njofton aplikantin për regjistrimin ose jo të PMB-së.

14. SPMB-ja mund ta ndërpresë përkohësisht procedurën e regjistrimit, kur:

a) ka të dhëna të besueshme se aplikanti e ka futur në treg PMB-në përpara se ajo të jetë regjistruar;

b) në dosjen e regjistrimit mungojnë të dhënat e kërkuara sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, duke vënë në dijeni aplikantin për plotësimin e tyre.

15. SPMB-ja mund ta ndërpresë përfundimisht procedurën e regjistrimit, kur:

a) PMB-ja e futur në treg para përfundimit të procedurave të regjistrimit nuk është tërhequr nga tregu;

b) nuk sigurohen të dhënat e kërkuara sipas pikës 1 të këtij kreu, deri në një muaj pas vënies në dijeni të të interesuarit për plotësimin e tyre.

16. SPMB-ja ia heq të drejtën e regjistrimit të PMB-ve aplikantit, nëse ai ka futur, në mënyrë të përsëritur, një PMB të paregjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

V. DOKUMENTI I REGJISTRIMIT, AMBALAZHIMI I PMB-VE

1. Dokumenti i regjistrimit të PMB-së përmban certifikatën e regjistrimit dhe etiketën e PMB-së. Ai lëshohet nga drejtuesi i SPMB-së.

Dokumenti i regjistrimit të PMB-së mbahet në tri kopje origjinale, nga të cilat njëra mbahet në arkivin e ministrisë, që mbulon fushën e bujqësisë, njëra në arkivin e SPMB-së, ndërsa kopja e tretë i jepet aplikantit.

1.1 Në certifikatën e regjistrimit (formati 1), e cila plotësohet në gjuhën shqipe dhe anglisht, jepen të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Emri tregtar i PMB-së;

b) Numri dhe data e regjistrimit;

c) Emri i aplikantit dhe adresa e tij;

ç) Lloji i regjistrimit (regjistrim, riregjistrim, ndryshim formulimi etj.);

d) Tipi i PMB-së (fungicid, insekticid, nematocid etj.);

dh) Emri i lëndës/ve vepruese të tij;

e) Klasifikimi i PMB-së (shumë helmues, helmues etj.), duke theksuar shënimin për PMB-të me rrezikshmëri të lartë;

ë) Përmbajtja e lëndës/ve vepruese në %, gr/lit. ose gr/kg;

f) Formulimi i PMB-së, sipas shtojcës VII, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

g) Pamja e jashtme e tij (granula me ngjyrë ..., lëng me ngjyrë…, pluhur me ngjyrë .... etj.);

gj) Kushtëzimet, që eventualisht mund të shoqërojnë regjistrimin;

h) Afati i përfundimit të regjistrimit;

i) Mënyra e përdorimit të PMB-së (me shënimin: shih etiketën bashkëlidhur);

j) Çdo specifikim tjetër, që mendohet i nevojshëm.

1.2 Në etiketën e PMB-së (formati 2) duhet të tregohen qartë dhe në mënyrë të pashuajtshme të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Emri tregtar dhe përcaktimi “Produkt për mbrojtjen e bimëve”;

b) Emri dhe adresa e mbajtësit të dokumentit të regjistrimit;

c) Për PMB-të e klasifikuara “PMB me rrezik të lartë”, të shënohen shprehjet: “PMB me rrezik të lartë”, “Të përdoret vetëm nga përdorues profesionistë”;

ç) Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-së, si dhe/ose të ambalazhuesit përfundimtar të PMB-së (nëse ndodh);

d) Emri/emrat e lëndës/ve vepruese. Nëse nuk figuron më emërtimi i saj i zakonshëm ISO dhe, nëse nuk është e pranishme as tek kjo e fundit, lënda vepruese përcaktohet (tregohet) me emërtimin e

saj kimik, sipas normave IUPAC;

dh) Përmbajtja e lëndës/ve vepruese te PMB-ja;

e) Emrat e lëndëve mbushëse, të papastërtive, etj, si dhe përmbajtja e tyre te PMB-ja;

ë) Numri i partisë së mallit ose shenja të tjera identifikuese;

f) Rreziqet e veçanta për shëndetin e njerëzve, të kafshëve e ndikimit në mjedis, të dhëna sipas frazave të rrezikut (R) dhe simboleve standarde të përcaktuara në shtojcat IV dhe V, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

g) Masat për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve dhe mjedisit, të dhëna në përputhje me frazat standarde të sigurisë (S), të përcaktuara në shtojcën VI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

gj) Shenjat e përgjithshme, në rast helmimi, udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun;

h) Tipi i formulimit;

i) Tipi i PMB-së (p.sh. insekticid, herbicid, etj.);

j) Sasia neto e PMB-së apo e lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë;

k) Mënyra e veprimit (p.sh., sistemik, kontakti, me veprim parambrojtës, kurativ etj.);

l) Përdorimi, për të cilin PMB-ja është regjistruar;

ll) Instruksionet për përdorimin, si dhe dozat e përdorimit, të shprehura në sistemin metrik, për kulturat dhe kushtet specifike bujqësore, agroteknike dhe mjedisore;

m) Kushtet specifike bujqësore, të mjedisit dhe të shëndetit të bimëve, në të cilat PMB-ja mund të përdoret ose jo;

n) Rekomandime për shmangien e rezistencës;

nj) Intervali i sigurisë ndërmjet kohës së përdorirnit të PMB-së: dhe

i) mbjelljes së bimës, ku përdoret;

ii) mbjelljes së bimëve pasardhëse;

iii) hyrjes së njerëzve apo kafshëve në zonën, ku është përdorur PMB-ja;

iv) vjeljes së prodhimit;

v) përdorimit të bimës, për shitje ose për konsum (karenca);

vi) përdorimit të PMB-ve të tjera në të njëjtën zonë ose mbi të njëjtën bimë;

o) Të dhëna relative për fitotoksicitetin, ndjeshmërinë e kultivarëve të ndryshëm, dhe ndaj çdo efekti të padëshirueshëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi produktet bimore ose ato me origjinë bimore, bashkërisht me intervalet e vërejtura ndërmjet aplikimit dhe mbjelljes së kulturës në fjalë ose të kulturës pasardhëse;

p) Instruksion për asgjësimin e PMB-së dhe të ambalazheve, në kushtet e sigurisë absolute;

q) Data e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje;

r) Rekomandimet për kushtet e ruajtjes;

s) Të shkruhet "Lexo instruksionin para përdorimit" dhe instruksione të tjera, kur PMB-ja shoqërohet me fletëpalosje;

t) Instruksione për përdorimin pa rrezik të PMB-së apo të ambalazhit të saj, që duhet te jetë në përputhje me të gjitha kërkesat zyrtare për etiketimin e produkteve apo të substancave të rrezikshme.

2. Kur nuk ka vend mbi ambalazhin e PMB-së, për të vendosur të dhënat mbi etiketë, sipas përcaktimeve të pikës 1.2 të këtij kreu, kërkesat e shkronjave "ll", "nj" dhe "o" mund të shkruhen në një fletëpalosje të veçantë, që shoqëron mallin (ambalazhin bazë) deri te përdoruesi i fundit. Kjo fletëpalosje vlerësohet si pjesë e etiketës.

3. Etiketa e ambalazhit të PMB-së nuk duhet të përmbajë shënime të tilla si: "jo helmues", "i padëmshëm" ose shënime të tjera të ngjashme. Megjithatë është e mundur të tregohet mbi etiketë se PMB-ja mund të përdoret kur bletët ose insektet e dobishme janë në aktivitet apo kur kulturat dhe/ose barërat e këqija janë në lulëzim, ose të vendosen shënime të tjera analoge, që njoftojnë për mbrojtjen e bletëve dhe të insekteve të dobishme, nëse regjistrimi parashikon qartësisht përdorimin gjatë periudhave të pranisë së bletës ose të organizmave të tjera të specifikuara dhe që rreziqet për to janë të parëndësishme.

4. Në etiketën e PMB-së duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme për përdorimin e duhur dhe pa rrezik të saj.

5. Etiketa duhet të jetë rezistente në kushte normale të ruajtjes, manipulimit ose përdorimit dhe duhet të sigurohet që ajo të mbetet e lexueshme gjatë të gjithë kohës së nevojshme për përdorimin e

PMB-së.

6. Simbolet e rrezikut duhet të vendosen sipas përcaktimeve të shtojcës IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe duhet të jenë të stampuara me ngjyrë të zezë mbi sfond të verdhë-portokalli.

7. Etiketa shkruhet në gjuhën zyrtare shqipe.

8. Etiketa vendoset mbi ambalazhin bazë të PMB-së, si më poshtë vijon:

8.1 Për PMB-të në formulime të ngurta (pluhura, granula etj.):

a) e stampuar direkt mbi paretet e ambalazhit bazë ose e ngjitur në mënyrë të pashqitshme mbi këtë ambalazh;

b) në rastet kur kjo është e pamundur, për arsye të ambalazhimeve të vogla (50-100 gr ose ml) dhe shumë të vogla (deri 50 gr ose ml), zbatohen kërkesat e pikës 2 të këtij kreu.

8.2 Për PMB-të në formulime të lëngëta, etiketa ngjitet në mënyrë të pashqitshme mbi ambalazhin bazë dhe, për ambalazhime të vogla (deri 50 ml), zbatohen kërkesat e pikës 2 të këtij kreu.

9. Është veçanërisht e detyrueshme që, për rastet e përcaktuara në pikat 8.1 e 8.2 të këtij kreu, të shënohen, në mënyrë të pakorrigjueshme, të dhënat e mëposhtme të etiketës së PMB-së:

a) Nr. i serisë së PMB-së, që importohet;

b) Data e prodhimit;

c) Periudha e ruajtjes.

10. Ambalazhimi i PMB-ve duhet të plotësojë kërkesat, si më poshtë vijon:

a) Të jetë i projektuar dhe realizuar në mënyrë të tillë, që të mos lejojë derdhje apo rrjedhje në mjedis gjatë ruajtjes, transportit, manipulimit apo tregtimit, me përjashtim të rastit kur kjo derdhje bëhet për arsye sigurie;

b) Materialet përbërëse të ambalazhit të mos degradohen nga kontakti me PMB-në, që ndodhet brenda tij, dhe të mos krijojnë lëndë të rrezikshme nga ndërveprimi kimik me PMB-në;

c) Të gjitha pjesët e ambalzhit të jenë të qëndrueshme në kushte normale të transportit, ruajtjes, tregtimit dhe përdorirnit;

ç) Enët të jenë të pajisura me sistem mbylljeje, që mund të jetë i ripërdorshëm, të jenë të projektuara në mënyrë të tillë që i njëjti ambalazh të mund të mbyllet shpeshherë, pa shkaktuar derdhje ose rrjedhje të PMB-së;

d) Cilado enë, e çdo madhësie, që përmban PMB, të klasifikuara “shumë helmues”, “helmuese” ose “gërryese”, duhet të përshtatet me një mbyllje sigurie për mbrojtjen e fëmijëve dhe duhet të ketë të shënuar në një vend të dukshëm një udhëzim rreziku paralajmërues, në rast kontakti me të;

dh) Cilado enë, e çdo madhësie, që përmban PMB, të klasifikuara “të dëmshme”, “ekstremisht të ndezshme” ose “lehtësisht të ndezshme”, duhet të ketë të shënuar një udhëzim rreziku paralajmërues, në rast kontakti me të;

e) Të jetë i mbyllur në origjinë dhe i vulosur, në mënyrë të tillë që, pasi ai të hapet për herë të parë, vula të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme.

11. Aplikanti, që kërkon të bëjë ambalazhimin e PMB-ve të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, detyrohet të paraqesë te SPMB-ja:

a) njoftimin paraprak për periudhën (data e fillimit dhe e përfundimit), që do të ambalazhojë PMB-të;

b) kontratën për ambalazhim, të lidhur me ambalazhuesin e PMB-ve;

c) deklaratën për çdo ngarkesë të PMB-ve, që do të ambalazhojë, e paraqitur 10 ditë para hyrjes së saj në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ç) mostrat për llojin dhe madhësinë e ambalazhit bazë, që do të përdorë për çdo PMB, për miratim paraprak të tij.

PMB-të e ambalazhuara tregtohen vetëm pas verifikimit paraprak nga Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve, në DRBUMK, për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në pikën 13 të këtij kreu.

12. Çdo person, që kërkon të merret me ambalazhimin e PMB-ve, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqesë te SPMB-ja miratimin nga organet kompetente shtetërore dhe sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për kryerjen e kësaj veprimtarie.

13. Ambalazhuesi i PMB-ve detyrohet:

a) të zbatojë kërkesat e përcaktuara në pikat 8, 9 e 10 të këtij kreu;

b) të shënojë tek etiketa e PMB-së emrin së bashku me adresën e impianteve të ambalazhimit;

c) të njoftojë, me shkrim, Inspektoratin e Mbrojtjes së Bimëve, 5 ditë para fillimit të ambalazhimit;

ç) të vendosë numrin e serisë për çdo parti malli të ambalazhuar pas miratimit nga Inspektorati i Mbrojtjes së Bimëve, në DRBUMK, duke bërë, njëkohësisht, regjistrimin e tij në një regjistër të veçantë;

d) të njoftojë Inspektoratin e Mbrojtjes së Bimëve, në DRBUMK, për përfundimin e ambalazhimit të PMB-ve.

VI. REGJISTRIMI, MODIFIKIMI, ANULIMI, ÇREGJISTRIMI, RIREGJISTRIMI DHE ZGJERIMI I FUSHËS SË PËRDORIMIT TË PMB-VE

1. Afatet e vlefshmërisë së regjistrimit të PMB-ve janë, si më poshtë vijon:

1.1 Regjistrimi i një PMb-je, lënda/lëndët vepruese, si dhe shtuesit ose bashkëvepruesit e të cilit janë në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet sipas afateve të përcaktuara në këtë shtojcë.

1.2 Regjistrimi i një PMB-je, lënda/lëndët vepruese, si dhe shtuesit ose bashkëvepruesit e të cilit nuk janë në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, bëhet për një periudhë deri 5 vjet.

1.3 Regjistrimi i një PMB-je, që ka në përmbajtje një lëndë vepruese të re, mund të bëhet për një periudhë të përkohshme, por jo më shumë se tre vjet, për të lejuar një vlerësim gradual të vetive të lëndëve të reja vepruese dhe për të lehtësuar disponibilitetin për bujqësinë të PMB-ve të reja.

1.4 Regjistrimi i një PMB-je identike me një PMB, të regjistruar më parë, është i kufizuar në të njëjtën periudhë kohe dhe u nënshtrohet të gjitha vendimeve, që mund të merren për PMB-në e regjistruar më parë.

1.5 Regjistrimi i një PMB-je, me natyrë inorganike, bëhet për një periudhë 10-vjeçare.

2. Kur luftimi i një paraziti gjykohet se nuk realizohet me PMB-të e regjistruara, autorizohet përdorimi, i kufizuar dhe i kontrolluar, i një PMB-je. Regjistrimi bëhet nga drejtuesi i SPMB-së, për një periudhë të kufizuar kohe, por jo më shumë se 4 muaj, si dhe për një sasi të caktuar të PMB-së, që do të përdoret.

3. Rishikimi i regjistrimit të një PMB-je kryhet në rastet kur:

a) kërkesat, që duhet të plotësojë PMB-ja, sipas pikës 7 të kreut II të këtij vendimi, nuk janë të mjaftueshme;

b) njëra nga kushtet, ku është bazuar regjistrimi, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, është ndryshuar, në mënyrë thelbësore;

c) aplikanti e kërkon, me shkrim, një gjë të tillë, duke paraqitur dokumentacionin shtesë për dosjen e regjistrimit;

ç) përdorimi i PMB-së mund të sjellë rreziqe për shëndetin e njerëzve, të kafshëve ose të mjedisit.

4. SPMB-ja mund të kërkojë kryerjen e provave, me karakter agronomik, toksikologjik dhe mjedisor për PMB të veçanta.

5. Modifikimi i dokumentit të regjistrimit të një PMB-je kryhet kur ka ndryshim:

a) të emrit tregtar të saj;

b) të mbajtësit të dokumentit të regjistrimit;

c) në transferimin e fabrikimit të PMB-së dhe/ose të lëndës/ve vepruese në një stabiliment tjetër prodhues;

ç) në peshën ose vëllimin e PMB-së, në periudhën dhe kushtet e ruajtjes, si dhe në tipin e materialin e ambalazhit bazë të tij;

d) të mënyrave të përdorimit dhe sasive të përdorura, në bazë të zhvillimeve të njohurive, shkencore dhe teknike.

6. Anulimi i regjistrimit të një PMB-je kryhet në rastet kur:

a) PMB-ja nuk plotëson kushtet për të qenë e regjistruar, sipas kërkesave të parashtruara në këtë vendim;

b) vërehet se në dosjen e regjistrimit janë paraqitur të dhëna false ose të gabuara;

c) ka të dhëna se aplikanti e ka futur në treg PMB-në përpara se të ketë filluar procedura për regjistrim;

ç) aplikanti e kërkon vetë një gjë të tillë;

d) PMB-ja nuk plotëson performancat e parashikuara dhe efektet, që priteshin, sipas specifikimeve të dhëna në dosjen e saj;

dh) të dhënat e reja specifike tregojnë se tregtimi dhe përdorimi i kësaj PMB-je përbën një rrezik, që vlerësohet i papranueshëm.

7. Kur drejtuesi i SPMB-së anulon regjistrimin, duhet të njoftojë, me shkrim, mbajtësin e tij (aplikantin), duke dhënë shpjegime të hollësishme për arsyet e marrjes së këtij vendimi.

Pas anulimit, tregtarët janë të detyruar t'ia kthejnë PMB-në mbajtësit të dokumentit të regjistrimit, i cili, me shpenzimet e veta dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, duhet të bëjë heqjen nga tregu.

8. Çregjistrimi i një PMB-je kryhet kur:

a) ajo përmban lëndë vepruese, si dhe shtues ose bashkëveprues, të cilët nuk janë miratuar për t'u futur ose janë hequr nga shtojca II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) aplikanti e kërkon, me shkrim, një gjë të tillë;

c) ka përfunduar afati i regjistrimit të saj.

8.1 Kur drejtuesi i SPMB-së kryen çregjistrimin e PMB-së, duhet të njoftojë, me shkrim, mbajtësin e saj, duke dhënë shpjegime të hollësishme për arsyet e marrjes së këtij vendimi.

8.2 Pas çregjistrimit, nëse PMB-ja është ende në treg, duhet të përdoret brenda një periudhe 1 - 2-vjeçare, por pa kaluar afatet e skadencës së saj.

Nëse, edhe pas këtij veprimi, mbetet sasi PMB-je gjendje, tregtarët janë të detyruar ta kthejnë atë te mbajtësi i dokumentit të regjistrimit.

9. Kur mbaron afati i regjistrimit të një PMB-je, mund të kryhet rinovimi i regjistrimit të saj, nëse:

a) është bërë kërkesa me shkrim nga aplikanti, si dhe është dorëzuar dokumentacioni, sipas kërkesave të shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, një vit përpara përfundimit të afatit të regjistrimit;

b) konfirmohet se kërkesat e përshkruara në këtë vendim, vazhdojnë të plotësohen.

9.1 Rinovimi i regjistrimit u nënshtrohet të njëjtave procedura, që ndiqen për regjistrimin.

9.2 SPMB-ja, kur e gjykon të nevojshme, mund t'i kërkojë aplikuesit të japë informacion të mëtejshëm, për të vendosur për rinovimin ose jo të regjistrimit.

10. Zgjerimi i fushës së përdorimit të një PMB-je mund të bëhet, nëse kërkohet nga institucione shkencore dhe kërkimore, shoqata të prodhimit bujqësor ose nga mbajtësi i dokumentit të regjistrimit.

Zgjerimi i fushës së përdorimit të një PMB-je të regjistruar më parë lejohet, kur:

a) është paraqitur, paraprakisht, nga kërkuesit e përmendur në paragrafin e parë dokumentacioni i pajisur me informacionin, që motivon se kushtet e përcaktuara në pikën 7 të kreut II të këtij vendimi, janë të pranueshme;

b) garantohet një informacion, i plotë dhe specifik, për përdoruesit e PMB-së, rreth instruksioneve për përdorim, duke plotësuar etiketën etij.

11. Nëse paraqitet një kërkesë për regjistrimin e një PMB-je, të regjistruar paraprakisht në një shtet anëtar të BE-së, me referim specifik dhe elemente krahasimi, të pajisura me dokumente justifikuese, SPMB-ja:

a) nuk kërkon përsëritje të provave dhe të analizave tashmë të kryera me metoda të harmonizuara, në nivel komunitar;

b) e regjistron PMB-në, nëse ajo përmban në mënyrë unikale lëndë vepruese, që janë në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që të jenë të vlerësuara nga një shtet i BE-së, që ka lëshuar autorizimin origjinal, në zbatim të parimeve uniforme, të përshkruara sipas shtojcës VII, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Në regjistrimin, sipas pikës 11 të këtij kreu, mund të përcaktohen (stabilizohen):

a) përshkrime të motivuara, të rrjedhura nga përdorimi në parametra të tjera, relative ndaj kushteve të tregtimit e të përdorimit të PMB-së, me qëllim që të garantohet mbrojtja e shëndetit të tregtarëve, të përdoruesve dhe të punëtorëve;

b) kufizime të motivuara të përdorimit, me qëllim që të mënjanohen rreziqet e ekspozimit në të ushqyerit e konsumatorit, e shprehur në sasi mbetjesh më të larta në dozën ditore, të pranueshme.

13. Në raste të kushteve jo të krahasueshme bujqësore, fitosanitare, klimatike dhe mjedisore, regjistrimi sipas pikës 11 të këtij kreu, mund të parashikojë, me pëlqimin e aplikuesit, modifikime në

kushtet e përdorimit, me qëllim që t'i bëjë pa ndikim këto kushte jo të krahasueshme (jo të ngjashme).

14. Nëse SPMB-ja ka parasysh një motiv të vlefshëm, se një PMB e regjistruar ose që është gjykuar për t'u regjistruar, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, përbën një rrezik për shëndetin e njeriut, të kafshëve ose për mjedisin, mund ta kufizojë ose pengojë përkohësisht përdorimin dhe/ose shitjen e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtuesi i SPMB-së informon menjëherë zotëruesin e dokumentit të regjistrimit për një vendim të tillë, duke dhënë arsyet përkatëse.

VII. KËRKIMI DHE ZHVILLIMI

1. Të drejtën e përdorimit, për qëllime eksperimentale, të PMB-ve e kanë institucionet kërkimore-shkencore, të përcaktuara në pikat 2, 3, 4 e 5 të kreut II të këtij vendimi.

2. Gjithashtu, këtë të drejtë e kanë dhe entet, organizmat, institucionet ose personat e tjerë, të miratuar nga drejtuesi i SPMB-së, nëse plotësohen kërkesat për:

a) PMB-në, që do të përdoret gjatë eksperimentimit, kërkimit apo provës;

b) veçoritë kimike, fizike dhe biologjike të PMB-së, siç përcaktohet nga provat e miratuara laboratorike, përfshirë dhe një dosje, që përmban të dhënat e disponueshme, për të lejuar vlerësimin e efekteve të mundshme mbi njeriun, kafshët dhe mjedisin;

c) mjediset, pajisjet, kushtet dhe procedurat, që do të përdoren për qëllime eksperimentimi, kërkimi apo prove me PMB-të, duke vërtëtuar përshtatshmërinë e tyre me qëllimet e përdorimit;

ç) të gjitha masat, që gjykohen të arsyeshme nga drejtuesi i SPMB-së, gjatë fazës së eksperimentit, kërkimit apo provës;

d) masat, që duhet të merren, kur njerëzit, kafshët, bimët apo mjedisi bien në kontakt me PMB-në;

dh) hollësitë e planit të kontingjencës, në rastet e kontaminimit apo përhapjes së këtyre PMB-ve;

e) emrin dhe kualifikimet e aplikantit, të personit përgjegjës për kryerjen e eksperimentit, të kërkimit apo provës, dhe, sipas rastit, edhe të personave të tjerë, që do të jenë të angazhuar në këtë veprimtari;

ë) të dhënat e kontaktit për aplikantin;

f) hollësitë për largimin apo shkatërrimin e PMB-ve dhe të materialeve të tjera, pas përdorimit në këtë veprimtari;

g) kushtet dhe informacione të tjera, për të cilat drejtuesi i SPMB-së mund të gjykojë se duhen kërkuar me shkrim.

2.1 Për lëshimin e autorizimit, drejtuesi i SPMB-së duhet:

a) të marrë parasysh rezultatet e çdo inspektimi apo prove, që është kryer nga persona të autorizuar, me qëllim që të verifikohet ose të përcaktohet informacioni i pikës 2 të këtij kreu;

b) të sigurohet se eksperimenti, kërkimi apo prova kryhen sipas rregullave dhe pa rrezik;

c) të sigurohet se personi i autorizuar ka në dispozicion ekspertizën dhe aftësinë për të përdorur, pa rrezik, PMB-të, për të cilat është autorizuar të kryejë eksperimentin, kërkimin apo provën;

ç) të sigurohet se do të merren masat e duhura parandaluese, në çdo kohë, nga personi i autorizuar ose nga punonjësit dhe përfaqësuesit e tij;

d) të sigurohet se mjediset, pajisjet, procedurat dhe plani i kontingjencës janë të përshtatshme.

2.2 Autorizimi i lëshuar sipas pikës 2 të këtij kreu, duhet të përfshijë eksperimentimin, kërkimin dhe provën për PMB-të, dhe është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 90 ditë.

2.3 Mbajtësi i autorizimit duhet të ndërmarrë të gjitha masat, për të siguruar plotësimin e vazhdueshëm të kërkesave, të përcaktuara në këtë autorizim.

Ai duhet të njoftojë menjëherë drejtuesin e SPMB-së për ndryshimin e çdo informacioni të dhënë në çastin e paraqitjes së kërkesës për marrjen e autorizimit.

2.4 Drejtuesi i SPMB-së nuk e lëshon autorizimin, në përputhje me pikën 2 të këtij kreu, kur ka arsye të mjaftueshme për:

a) të dyshuar se informacioni i dhënë në çastin e paraqitjes së kërkesës për autorizim është fals apo i gabuar;

b) të menduar se rreziku mbi njerëzit, kafshët apo mjedisin nuk justifikohet nga përfitimi i mundshëm nga eksperimenti, kërkimi apo prova.

2.5 Me mbarimin e afatit të autorizimit, drejtuesi i SPMB-së mund ta rinovojë atë, kur:

a) ka marrë kërkesë nga mbajtësi i autorizimit;

b) gjykon se kërkesat e pikës 2 të këtij kreu, vazhdojnë të plotësohen.

2.6 Drejtuesi i SPMB-së mund t'i kërkojë aplikuesit informacion shtesë, që ai e mendon të nevojshëm për rinovimin e autorizimit, si dhe mund të kushtëzojë atë, kur e gjykon të arsyeshme.

2.7 Drejtuesi i SPMB-së mund të pezullojë ose anulojë autorizimin e lëshuar sipas pikës 2 të këtij kreu, kur:

a) informacioni i dhënë në çastin e marrjes së autorizimit është fals apo i gabuar;

b) nuk plotësohen më kërkesat e pikës 2 të këtij kreu;

c) mbajtësi i autorizimit e kërkon një gjë të tillë.

Kur drejtuesi i SPMB-së pezullon ose anulon një autorizim, ai duhet të njoftojë, me shkrim, mbajtësin e autorizimit, duke dhënë arsyet e marrjes së këtij vendimi.

2.8 Pas kërkesës me shkrim të mbajtësit të autorizimit, drejtuesi i SPMB-së mund të ndryshojë autorizimin e lëshuar sipas pikës 2 të këtij kreu, kur e gjykon se ky ndryshim është i justifikuar.

VIII. INFORMACION PËR EFEKTET E RREZIKSHME, MBROJTJA (REZERVIMI) E TË DHËNAVE, KONFIDENCIALITETI

1. Zotëruesi i dokumentit të regjistrimit duhet të komunikojë me SPMB-në për çdo informacion të ri për PMB-në, për mbetjet e saj ose për lëndën/t vepruese, për efektet potenciale të rrezikshme për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve, për ujërat nëntokësore dhe për mjedisin.

2. Në regjistrimin e një PMB-je, të dhënat e dosjes së regjistrimit nuk përdoren në favor të aplikantëve (kërkuesve) të tjerë, nëse:

a) aplikanti (kërkuesi) nuk ka rënë dakord me aplikantin e parë, që është i ligjshëm, për të kërkuar një informacion të tillë;

b) për një periudhë prej 10 vjetësh, duke filluar nga data e regjistrimit të parë të PMB-së në një vend anëtar të BE-së, regjistrimi është pasuar me përfshirjen në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të lëndës vepruese, që përmbahet në PMB;

c) për një periudhë jo më shumë se 10 vjet, dhe duke parashikuar normat kombëtare në fuqi pas regjistrimit të parë të PMB-së në çdo vend anëtar, një regjistrim i tillë paraprin përfshirjen në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të lëndës vepruese, që përmbahet në PMB.

3. Pas marrjes së kërkesës nga mbajtësi i autorizimit, SPMB-ja shqyrton të gjithë informacionin e marrë, në përputhje me këtë vendim, si informacion, industrial apo tregtar, me natyrë konfidenciale.

4. Nëse mbajtësi i autorizimit ose përfaqësuesi i tij zbulojnë përdorimin e informacionit konfidencial, ata informojnë, menjëherë, SPMB-në.

5. Në bazë të lirisë së aksesit në informacionet për mjedisin, merren masa me qëllim që informacionet e dhëna nga aplikantët, si sekrete industriale apo tregtare, të vlerësohen të rezervuara në kërkesën e aplikantit të interesuar në përshkrimin e një lëndë vepruese në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, ose të aplikantit të regjistrimit të një PMB-je, dhe paraprin pranimin nga SPMB-ja të motivacionit të duhur nga aplikanti.

6. Pa kundërshtuar dispozitat e tjera ligjore mbi të drejtën e aksesit në informacion, nuk vlerësohen konfidenciale të dhënat, si më poshtë vijon:

a) Emri dhe përmbajtja e lëndës/lëndëve vepruese dhe emri i PMB-së;

b) Emri i lëndëve të tjera të rrezikshme;

c) Informacioni bazë për të plotësuar kërkesat për etiketimin, sipas pikës 1.2 të kreut V të këtij vendimi;

ç) Të dhënat fiziko-kimike për lëndët vepruese dhe PMB-të;

d) Metodat e përdorura për të bërë të padëmshme lëndët vepruese dhe PMB-të, përfshirë antidotet dhe mjetet për trajtimin e rasteve të helmimit në njerëz dhe kafshë, nga këto PMB dhe lëndë vepruese;

dh) Përmbledhjen e rezultateve të provave për sigurinë e lëndëve vepruese dhe të PMB-ve te njerëzit, kafshët dhe mjedisi, si dhe efikasitetin e tyre te bimët;

e) Metodat e rekomanduara dhe masat për të ulur rrezikun, që mund të vijë nga përdorimi, ruajtja dhe transporti i tyre, si dhe për të shmangur rrezikun e ndezjes ose të një natyre tjetër;

ë) Metodat e analizës, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Metodat për largimin dhe bërjen të padëmshme të PMB-ve, lëndëve vepruese dhe/ose të

ambalazhit të tyre;

g) Masat, për pastrimin, në rast të rrjedhjeve aksidentale;

gj) Masat e ndihmës së shpejtë, në rast helmimi të personave.

IX. DISPOZITA TË VEÇANTA

1. Regjistri i lëndëve vepruese përmban të dhënat e mëposhtme:

a) Numrin e referencës në regjistër (numri i regjistrimit);

b) Emrin e njohur të lëndës vepruese;

c) Numrin e regjistrit të abstraktit kimik;

ç) Klasifikimin e lëndës vepruese, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi ose vënien re se ky klasifikim nuk është kryer ende;

d) Datën, kur është marrë vendimi për klasifikimin, dhe të gjitha të dhënat për ndryshimet në kohë të klasifikimit të lëndëve vepruese;

dh) Të gjitha të dhënat e tjera, që mund të kërkohen nga SPMB-ja.

2. Pas regjistrimit, PMB-të numërtohen dhe ruhen në arkivin e SPMB-së, ku plotësohen edhe këto të dhëna:

a) Numri i referencës në regjistër (numri i regjistrimit);

b) Data e regjistrimit të fundit dhe të gjitha të dhënat për regjistrimet e kryera me parë;

c) Data, kur mbaron afati i regjistrimit;

ç) Emri tregtar, me të cilin PMB-ja do të hidhet në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) Emri dhe numri i regjistrit, sipas abstraktit kimik, për të gjitha lëndët vepruese, që përmbahen në formulën e PMB-së;

dh) Përcaktimi nëse PMB-ja është “PMB e rrezikshme” ose “PMB me rrezik të lartë”;

e) Emri dhe të dhënat e kontaktit për mbajtësin e dokumentit të regjistrimit (aplikantin);

ë) Çdo e dhënë tjetër, që mund të kërkohet.

3. Të dhënat, që shënohen në regjistrin e PMB-ve, janë:

a) të publikueshme, ku përfshihen të dhënat sipas përcaktimeve të pikës 6 të kreut VIII të këtij vendimi;

b) të papublikueshme, ku përfshihen të dhënat, që aplikanti i ka deklaruar si konfidenciale, si dhe të dhëna të tjera, për përbërjen e formulimit dhe papastërtitë nga pikëpamja toksikologjike e ekotoksikologjike.

4. Reklama në median, e shkruar ose elektronike, lejohet vetëm për PMB-të e regjistruara dhe në përputhje me dokumentin e regjistrimit. Në varësi të tipit të reklamës, tekstet dhe figurat duhet të jenë të lexueshme e të dëgjueshme qartë, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me mbrojtjen e njerëzve, të kafshëve dhe të mjedisit.

5. SPMB-ja, me të ardhurat nga regjistrimi i PMB-ve, përgatit:

5.1 Listën e PMB-ve të regjistruara, sa herë që pëson ndryshime, dhe ua dërgon atë të gjitha strukturave vartëse të Inspektoratit të Mbrojtjes së Bimëve, subjekteve importuese dhe tregtuese të PMB-ve, si dhe personave apo subjekteve të tjera, të interesuara.

Lista përmban këto të dhëna:

a) Emrin tregtar të PMB-së;

b) Emrin e lëndës/lëndëve vepruese të saj;

c) Aplikantin (zotëruesin e dokumentit të regjistrimit të PMB-së);

ç) Prodhuesin (emrin, adresën e fabrikimit);

d) Klasifikimin e PMB-së, sipas parazitëve, që lufton (insekticid, herbicid, fungicid etj.);

dh) Klasifikimin e PMB-së sipas helmueshmërisë (shumë helmuese T^+, helmues -T etj.);

e) Datën dhe numrin e regjistrimit të PMB-së.

5.2 Në fund të vitit botohet një katalog i veçantë për PMB-të e regjistruara, ku përshkruhen të dhënat e tyre:

a) Emri tregtar;

b) Emri dhe përmbajtja e lëndës/lëndëve vepruese;

c) Përdorimi, vërejtje për përdorimin;

ç) Ndihma e parë në rast helmimi dhe këshilla për mjekun;

d) Ndikimi në mjedis;

dh) Periudha e trajtimit të fundit (karenca);

e) Kushtet e ruajtjes dhe të përdorimit të PMB-së;

f) Specifikime të tjera, që përmbahen në etiketë.

6. Tarifat për regjistrimin e PMB-ve përballohen nga aplikantët dhe ndahen në:

a) Tarifa administrative;

b) Tarifa për vlerësimin biologjik-agronomik, toksikologjik, ekotoksikologjik, si dhe për analiza të tjera, gjatë procedurës së regjistrimit.

7. Përcaktimi i tarifave administrative dhe mënyra e përdorimit të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të ministrit, që mbulon fushën e bujqësisë.

8. Tarifat e përmendura në shkronjën "b" të pikës 6 të këtij kreu, janë në varësi të kostos dhe derdhen në llogaritë e instituteve, që kryejnë vlerësimin e PMB-ve.

X. DISPOZITA KALIMTARE

Ripërtëritja e regjistrimit të PMB-ve ekzistuese u nënshtrohet të gjitha kërkesave dhe procedurave për regjistrim, që përcaktohen në këtë vendim.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1561, datë 3.10.2008

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR PARANDALIMIN E LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PËR NJË QEVERISJE TRANSPARENTE, 2008-2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë ndërsektoriale për parandalimin e luftën kundër korrupsionit dhe për një qeverisje transparente, 2008-2013, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet grupi ndërministror i punës për strategjinë ndërsektoriale për parandalimin e luftën kundër korrupsionit dhe për një qeverisje transparente, 2008-2013, për rishikimin periodik të strategjisë dhe hartimin e planeve të integruara të veprimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E PARANDALIMIT, LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT E QEVERISJES TRANSPARENTE 2008-2013

KREU I
HYRJA

Shqipëria tre vjet më parë ishte vendi në të cilin korrupsioni galopant ishte shndërruar në sistem, tregu i vendit dominohej nga monopolet e qeveritarëve dhe zyrtarëve të lartë, prokurimet direkte ishin shndërruar në rregull, sipas raportit të Bankës Botërore rreth 1,4 miliardë dollarë në vit nga taksat dhe tatimet përfundonin në kontot personale të zyrtarëve të korruptuar dhe kontrabandistëve, shteti ligjor përjetonte goditje ekstreme, vendimet e gjykatave zbatoheshin me ngadalësi, shteti ligjor kishte një dobësi dhe rënie të madhe, krimi i organizuar kontrollonte dhe vendoste jo vetëm në rrugë, por edhe në dogana, tatime, gjykata, polici etj.

Raporte të tjera ndërkombëtare serioze faktuan se korrupsioni në Shqipëri ishte në nivelet me të larta të planetit, veçanërisht në dogana tatime, gjykata, polici, shëndetësi etj. dhe zbatim tejet i ngadaltë i reformave, lidhjet dhe simbioza me krimin e organizuar shndërruan korrupsionin në një

sistem në Shqipëri. Në këto kushte u krijua Task-Forca e luftës kundër korrupsionit, e kryesuar nga Kryeministri i vendit, e cila ndoqi procesin e reformave të thella të luftës kundër korrupsionit, ndër reformat më kryesore të ndërmarra deri sot.

Në kuadrin e kësaj lufte u shkurtua me 33%, administrata qendrore e vendit, u amendua ligji i konfliktit të interesit, ligji i lnspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive të Zyrtarëve, ligji i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, u vendos transparenca në shpenzimet operative të administatës, gjë që lejoi shkurtimin e tyre nga 3% në 2% të GDP, u ndaluan prokurimet direkte, u miratua ligji për mbrojtjen e informacionit të korrupsionit dhe shpërblimi me 6% të vlerës së përfituar. Reformave të thella iu nënshtruan tatimet dhe doganat, u vendosën e-taksa, e-dogana, e-prokurime.

Taksat u ulën dhe po kështu një seri tarifash u privatizuan ndërmarjet e mëdha: ARMO, KESH, TELECOM. U vendos regjistrimi elektronik i biznesit. Janë hequr mbi 103 leje dhe licenca.

U krijua Task-Forca e luftës kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, e cila ka penalizuar një numër të konsiderueshëm zyrtarësh.

Të gjitha këto reforma bënë të mundur përmirësimin e indeksit të perceptimit të korrupsionit me 0.5 pikë. Shqipëria që tre vjet më parë vendosej në grupin e 24 vendeve më të korruptuara, tani ka lënë prapa 95 vende të botës.

Megjithëkëtë korrupsioni sërish mbetet një problem serioz dhe i përhapur.

Prandaj dhe është e domosdoshme që për suksesin e mëtejshëm të luftës kundër korrupsionit:

- Zbatimi me rigorozitet i kuadrit ligjor ekzistues.
- Konsolidimi i të gjitha institucioneve të kontrollit administrativ dhe gjyqësor.
- Vazhdimi i mëtejshëm i reformave për parandalimin e korrupsionit.

KREU 2
VIZIONI, QASJA DHE PRIORITETET E QËLLIMET STRATEGJIKE

A.Vizioni

Vizioni i përgjithshëm është reduktimi progresiv e i qëndrueshëm i korrupsionit, forcimi i integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave në qeverisje.

Prioritet dhe qëllimi i vizionit të përgjithshëm është lufta dhe reduktimi progresiv e i qëndrueshëm i korrupsionit nëpërmjet:

- Refomave për parandalimin e tij;
- Forcimit të integritetit të institucioneve dhe promovimit të vlerave të qeverisjes;
- Monitorimit të gjithanshëm të fenomenit të korrupsionit, luftës kundër tij nga shoqëria civile dhe forcimi i rolit të saj;
- Ndëshkimit administrativ ligjor të zyrtarëve të korruptuar.

Zbatimi i përgjegjshëm i strategjisë antikorrupsion në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integnim (SKZHI), synon reduktimin progresiv e të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e vlerave në qeverisje nëpërmjet kultivimit e forcimit të mendësisë së shërbimit ndaj qytetarëve nga administrata publike, zbatimit të efektshëm e të barabartë të ligjit, përmirësimit të transparencës e informimit, zhvillimit të shpejtë e të qëndrueshëm ekonomik e njerëzor, cilësisë, përgjegjshmërisë e efektivitetit në qeverisje.

Përpjekjet në këtë fushë do të përqendrohen në veprime konkrete për reduktimin e korrupsionit dhe ndryshimin rrënjësor të mendësisë qeverisëse. Reduktimi progresiv e i qëndrueshëm i korrupsionit nevojit një ndërhyrje energjike që të angazhojë të gjitha burimet vendase dhe mbështetjen e ndihmën e ndërkombëtarëve.

Strategjia, me prioritetet e reformat e përcaktuara, bazohet në:

- platformën e përgjithshme të përqasjes gjithëpërfshirëse dhe të integruar në luftën kundër korrupsionit me një kombinim të balancuar të parandalimit, hetimit, dënimit dhe pjesëmarrës së publikut;
- parimin se veprimet korruptive janë e duhet të konsiderohen si vepra penale dhe të trajtohen qoftë në planin administrativ, qoftë në atë penal;
- ndjekjen e parimeve bazë të sundimit të ligjit e barazisë së plotë të qytetarëve para ligjit, mirëqeverisjes, përgjegjshmërisë, lidhjes organike ndërmjet parandalimit me hetimin e dënimin efektiv, bashkëpunimit dhe koherencës, transparencës dhe pjesëmarrjes, partneritetit efektiv ndërmjet sektorit publik dhe privat;
- ndjekjen e standardeve e praktikave më të mira ndërkombëtare, rajonale e të brendshme në

këtë fushë.

Të gjitha aspektet e strategjisë duhet:

- të udhëhiqen nga vendosmëria në respektimin e ligjit, përgjegjësia, bashkëpunimi, koherenca, transparenca, dialogu social dhe partneriteti publik-privat;
- të bashkërendohen me institucionet përgjegjëse e bashkëpunuese dhe me qeverinë;
- të udhëhiqen nga objektiva specifikë, realë, të arritshëm, të matshëm dhe të bazuara në kohë;
- të shoqërohen me një plan veprimi me masa dhe instrumente konkrete për realizimin e strategjisë;
- të paraprihen nga analiza të thelluara të situatës, faktorëve që ndikojnë pozitivisht dhe negativisht, si dhe parashikime reale mbi bazën e vlerësimit të rreziqeve;
- të mbështeten me edukimin, trajnimin dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm për të forcuar e konsoliduar kapacitetet;
- të jenë objekt i vlerësimit periodik të rreziqeve;
- të shprehen e zbatohen në tregues të matshëm dhe afate realiste e të detyrueshme.

B. Qasja, prioritetet dhe qëllimet e strategjisë

Prioritetet kryesore të strategjisë do të mbështeten në disa instrumente themelore që do të synojnë, sipas prioriteteve e objektivave:

- marrjen e masave efektive, racionale, të qëndrueshme dhe me efekte afatgjata, si dhe vënien në dispozicion të burimeve të domosdoshme për realizimin e tyre;
- përcaktimin strategjik të mjeteve të duhura ligjore e institucionale për të siguruar zbulimin e efektshëm të personave të dyshuar për vepra korruptive dhe garantuar përgjegjësinë e autorëve të veprimeve korruptive;
- identifikimin e fushave më të prekura dhe me rreziqe, si dhe arsyet e ekzistencës e të shtrirjes së korrupsionit; shmangien e paqartësive, kontradiktave e mangësive ligjore, përqendrimin në prioritete dhe zhvillimin e kuadrit të duhur analitik për mbledhjen e shqyrtimin e të dhënave mbi shfaqjet e korrupsionit në administratën publike, fushat e drejtësisë, financave, ekonomisë dhe sektorin privat;
- shoqërimin e masave ligjore e institucionale me fushata të qëndrueshme për të promovuar intolerancën ndaj fenomenit, konsoliduar bashkëpunimin e ngushtë me organizatat joqeveritare dhe median, për të zhvilluar e përfshirë edukimin antikorrupsion në programet e sistemit arsimor;
- sigurimin e hapjes dhe transparencës në zbatimin e masave parandaluese antikorrupsion dhe hetimin e veprave korruptive dhe të lidhura, duke ruajtur një ekuilibër të drejtë e të qëndrueshëm me mbrojtjen e domosdoshme të të dhënave personale dhe sekretit shtetëror, bankar a të biznesit;
- zhvillimin, azhurnimin e zbatimin e planeve të veprimit sektoriale të qëndrueshëm, me përqasje afatgjatë mbi bazën e strategjisë dhe në harmoni me strategjitë përkatëse sipas fushave;
- informimin dhe transparencën në mbështetje dhe në ndihmë të realizimit të prioriteteve e objektivave të përcaktuara.

Të dhënat dhe raportet në lidhje me korrupsionin gjatë viteve të fundit kanë vënë theksin, krahas shtrirjes së gjerë të fenomenit në vend, në mungesën e zbatimit efektiv të ligjit me pasojë brishtësinë e institucionalizimit të praktikave të mira në funksionimin e përditshëm të administratës publike, të drejtësisë, policisë apo doganave.

Ky fakt kërkon marrjen në konsideratë të dy përqasjeve të rëndësishme në përpjekjet për të reduktuar korrupsionin.

Së pari, duhet të krijohet normaliteti, duke ngritur dhe konsoliduar standardet dhe praktikat e mira në administratën publike dhe kryesisht në sektorë specifikë, si: arsimi, shëndetësia, organet e zbatimit të ligjit dhe drejtësia. Kjo përqasje angazhon një spektër të gjerë veprimesh, që synojnë parandalimin e korrupsionit, duke mbështetur në administrimin publik dhe në shoqëri, praktikat që nxisin integritetin dhe funksionojnë mbi bazën e standardeve të njohura të integritetit.

Përqasja e dytë synon hetimin dhe dënimin efektiv të shkeljeve ligjore në këtë fushë dhe të shmangieve nga standardet dhe përmbledh masa për të kundërvepruar ndaj praktikave korruptive, si dhe plotësimin e konsolidimin e kuadrit institucional për të siguruar hetim dhe dënim efektiv të tyre.

Në këtë mënyrë, lufta kundër korrupsionit do të bazohet në kombinimin e këtyre dy drejtimeve themelore, atë të parandalimit dhe atë të ndëshkimit të korrupsionit, të gërshetuara me mbështetjen, edukimin dhe konsolidimin e intolerancës ndaj këtij fenomeni nga publiku.

Së fundi, zbatimi i strategjisë sipas dy prioriteteve themelore të mësipërme kërkon rritjen e

konsolidimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit efektiv ndërmjet aktorëve përkatës vendas dhe ndërkombëtarë, që përbën infrastrukturën e domosdoshme në realizimin e prioriteteve të mësipërme.

Prioritetet themelore të strategjisë, sipas objektivave përkatës, do të përqendrohen në fushat e mëposhtme.

I. Parandalimi, transparenca, gjithëpërfshirja e edukimi

1. Forcimi i sistemit politik dhe i etikës së funksionimit publik;

2. Modernizimi e konsolidimi i procedurave;

3. Reformat sektoriale (kontrolli, klima e biznesit, shërbimi civil, prokurimi publik, arsimi, shëndetësia, financat, drejtësia, pushteti vendor etj.);

4. Konsolidimi i transparencës dhe integritetit në administratën publike;

5. Përafrimi i legjislacionit në fushën e luftës kundër korrupsionit;

6. Fushatat informuese dhe masa edukuese të qëndrueshme.

II. Hetimi dhe dënimi i korrupsionit

1. Sigurimi i efiçencës së ndjekjes penale, rritja e shpejtësisë së ndjekjes penale dhe gjykimit;

2. Rritja e integritetit dhe rezistencës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë;

3. Forcimi i mjeteve administrative në luftën kundër korrupsionit;

4. Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e korrupsionit.

III. Konsolidimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të brendshëm dhe ndërkombëtar

1. Konsolidimi i mekanizmave në bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit;

2. Konsolidimi mekanizmave të qëndrueshëm për shkëmbimin periodik të informacionit;

3. Zbatimi i efektshëm i instrumenteve antikorrupsion rajonale e ndërkombëtare.

KREU 3
POLITIKAT E QEVERISË

I. Parandalimi, transparenca, gjithëpërfshirja e edukimi

A. Forcimi i sistemit politik dhe i etikës së funksionimit publik

Forcimi i sistemit politik dhe i etikës së funksionimit publik do të arrihet nëpërmjet disa ndërhyrjeve të rëndësishme që synojnë reduktimin e imunitetit të zyrtarëve për çështje korruptive, reformimin e sistemit të financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, reformimin e sistemit zgjedhor dhe kthimin e besimit të publikut te zgjedhjet, rregullimin e veprimtarive të lobimit dhe ndikimit të vendimmarrjes politike e administrative, si dhe forcimin e rishikimin e kodeve të etikës dhe nxitjen e mekanizmave vetërregullues të etikës.

Me qëllim edukues dhe gjithëpërfshirës të publikut do të ndërmerren këto hapa:

- Do të përkthehet, publikohet dhe promovohet nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion libri i Transparency International i titulluar “TI Anti-Corruption Handbook (ACH): National Integrity System in practice” si dhe materiale të tjera informuese edukuese në lidhje me fenomenin e korrupsionit.

- Do të bëhet një fushatë e gjerë me qëllim sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikun në lidhje me çështjet e korrupsionit.

1. Financimi i partive politike dhe fushatave zgjedhore

Ndërhyrjet në këtë drejtim synojnë rregullime ligjore të regjimit të dhuratave individuale me origjinë private të siguruara nga partitë politike prej personave juridikë e fizikë për të rritur transparencën, duke vendosur kufizime racionale e realiste në vlerë dhe ndalime për shkak të origjinës të dhuratave të institucioneve publike, ndërmarrjeve private të shërbimit publik, organizmave fetarë, apo të bamirësisë.

Rritja e garantimi i transparencës së të ardhurave dhe të shpenzimeve kërkon vendosjen e rregullave dhe mekanizmave që e garantojnë atë, si deklarim të detyrueshëm të dhuruesit përtej një pragu të caktuar dhe publikim periodik.

Gjithashtu, parashikohet paraqitja periodike e llogarive pranë një autoriteti të specializuar kontrolli (ekzistues ose të krijuar) dhe sanksione efektive e proporcionale për shkeljet.

2. Reformimi i sistemit zgjedhor dhe kthimi i besimit të publikut te zgjedhjet

Përmirësimi i sistemit ligjor e institucional zgjedhor në përputhje me standardet ndërkombëtare do të garantojë realizimin efektiv të së drejtës së pjesëmarrjes në zgjedhje të qytetarëve brenda dhe jashtë vendit, shmangien e përjashtimit të zgjedhësve nga listat e votimit duke

institucionalizuar mekanizmat përkatës (regjistrin e gjendjes civile, kartat e identitetit të shtetasve dhe zonat zgjedhore të qëndrueshme).

3. Rregullimi i veprimtarive të lobimit

Mungesa e rregullimit ligjor të fenomenit të lobimit do të rregullohet nëpërmjet një kuadri rregullator që të garantojë regjistrimin e organizatave profesioniste të lobimit, garantimin e aksesit, deklarimin e veprimtarisë, transparencën e mjeteve dhe përcaktimin e instrumenteve e procedurave në përgjithësi për këtë çështje.

4. Forcimi e rishikimi i kodeve të etikës dhe mekanizmave vetërregullues

Forcimi i kërkesave e standardeve etike në institucionet publike synon rishikimin, shtrirjen, promovimin dhe eficiencën e tyre duke u përqendruar në:

- krijimin, rishikimin, forcimin dhe shtrirjen e kodeve të etikës në institucionet publike (shtrirje e tyre edhe në sistemin arsimor, shëndetësor, urdhrat profesionale, shoqatat profesionale të ekspertëve kontabël të autorizuara të miratuara, të arkitektëve etj.);
- përmirësimin e mekanizmave për fuqizimin e etikës dhe parandalimin e konfliktit të interesave, duke mbështetur instrumentet e kontrollit, siguruar efiçencën në bashkëpunimin me qytetarët për zbulimin dhe ndëshkimin e korrupsionit e të shkeljeve;
- promovimin e standardeve të etikës në funksionimin publik (debate, forume);
- forcimin e efiçencës në administrimin e standardeve etike;
- promovimin e kodeve të etikës në sektorin e biznesit;
- zbatimin e sistemeve të matjes së performancës dhe të vlerësimit;
- rishikimin e qartësimin e pozicioneve politike dhe të nivelit ndarës me shërbimin civil/administratën.

5. Kufizimi i imunitetit të zyrtarëve të lartë për çështje korruptive

Rishikimi i sistemit të imunitetit do të synojë që zyrtarëve të lartë t'iu kufizohet imuniteti nga hetimi dhe/ose ndjekja penale për veprat penale korruptive.

B. Modernizimi e konsolidimi i procedurave

Modernizimi i procedurave dhe i marrëdhënieve të jashtme të administratës do të jetë një proces i vazhdueshëm i përqendruar fillimisht në reformën rregullatore të licencimit me fokus prioritar sektorin e biznesit, i ndjekur dhe i shtrirë për të gjitha shërbimet publike në përgjithësi për publikun. Ky modernizim do të shkojë paralelisht me atë të marrëdhënieve të brendshme të administratës, duke refomuar procedurat administrative.

1. Reforma rregullatore e licencimit

Reforma rregullatore e procesit të licencimit synon listimin e kategorizimin e licencave sipas nomenklaturës, natyrës, përcaktimit proporcional të hierarkisë së vendimmarrës, rritjen e aksesit dhe shtrirjen e përdorimit të internetit, institucionalizimin e parimit të "miratimit të heshtur" përtej një afati të caktuar, rishikimin e harmonizimin tërësor të procedurave të licencimit nëpërmjet thjeshtimit e forcimit të standardeve, përcaktimin e kritereve të qarta, transparente dhe jodiskriminuese në veprimtaritë e licencimit, rritjen e kontrollit të zbatimit të funksionimit të veprimtarive të licencuara, planizimin e afatizimin e thjeshtimit të procedurave e kritereve të licencimit dhe të modernizimit të tyre në përputhje me programin e Task-Forcës për reformën rregullatore.

Vendosja e një mekanizmi mbikëqyrës nga këndvështrimi antikorruptiv i nismave ligjore dhe nënligjore për të parandaluar nismat që shtojnë licenca, centralizojnë vendimmarrjen, ose krijojnë hapësira abuzivizmi a korrupsioni.

2. Reforma e shërbimeve publike

Reforma e shërbimeve publike në përgjithësi synon modernizimin e sportelit të shtetit duke u përqendruar në disa prioritete bazë si sporteli unik (*one-stop-shop*), promovimi e rritja e standardeve të shërbimit, informatizimi i sistemit, decentralizimi i shërbimeve, zbatimi efiçent nëpërmjet vlerësimit e përfshirjes së përfituesit të shërbimeve.

Kjo reformë do të realizohet nëpërmjet një sërë masash, si:

- Listimi i të gjithë procedurave e kritereve të shërbimeve publike;
- Ulja e ndjeshme e barrierave administrative duke e kombinuar reduktimin, thjeshtimin e standardizimin me ngritjen e qendrave të shërbimit "një ndalim në një sportel";
- Nxitja e standardeve të kulturës së komunikimit, shërbimit, orientimit, aksesit të formularëve tip;
- Informatizimi i sistemit sipas fazave (nivel qendror e vendor) dhe shtrirja e përdorimit të e -

shërbimeve;

Decentralizimi i ofrimit të shërbimeve publike dhe përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve të natyrës publike;

- Zgjerimi e shumëfishimi i partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe privat mbi bazën e rregullave të qarta e transparente që mbështeten në parimet e tregut të lirë dhe të konkurrencës së ndershme;

- Zbatimi dhe kontrolli i zbatimit të ndershëm e të barabarte të standardeve, kritereve e procedurave për çdo biznes e individ nga çdo institucion publik;

- Vlerësimi i performancës dhe i cilësisë së shërbimeve duke vendosur kritere të krahasimit të realizimit faktik me kriteret e standardet;

- Ngritja e sistemeve të matjes së detyrueshme e të vlerësimit të performancës së çdo shërbimi publik nga përfituesit e/ose partnerët;

- Vendosja e kritereve në dhënien e shërbimeve publike duke u udhëhequr nga realizimi dhe mbështetja me buxhet e projekteve të cilat mbështesin realizimin e projekteve të qeverisë dhe nga administrimi me efektivitet e transparencë i fondeve publike;

- Thellimi i ndarjes së funksioneve politike, funksioneve rregullatore dhe funksioneve të ofrimit të shërbimeve e të kontrollit;

- Lehtësimi e thjeshtimi i procedurave për shërbimet publike të përhershme (energji elektrike, ujë i pijshëm, telefon, gjendje civile, shërbime sociale, shëndetësore etj.).

3. Reformimi i procedurave administrative

Rishikimi i të gjitha procedurave administrative do të ketë si synim prioritar shmangien e mundësive për korrupsion, abuzime dhe burokraci të tepërt dhe do të përqendrohet në rishikimin e rregulloreve të brendshme, modernizimin, rishikimin, përpunimin e standardizimin e dokumentacionit të brendshëm, rishikimin e harmonizimin e sistemit të apelimit administrativ (të përgjithshëm e specifik) dhe natyrshëm institucionalizimin e përgjithshëm dhe rritjen e dukshme të tranparencës së administratës publike.

Reformimi i procedurave administrative synon gjithashtu:

- rritjen e shkallës së informatizimit të operacioneve që kryhen nga administrata publike në të gjitha nivelet, duke lehtësuar e thjeshtuar procedurat, shkurtuar kohën e afatet e kryerjes së tyre, si dhe duke rritur saktësinë, cilësinë e shpejtësinë e rrjedhjes së informacionit dhe raportimit;

- sisteme efektive e efiçente të kontrollit të brendshëm që organizohen sipas rregullave të qarta, objektivave strategjikë, përbëhen nga struktura dhe organika efektive, të shoqëruara me një sistem funksional të caktimit të përgjegjësive, ndarjes së detyrave dhe delegimit të kompetencave;

- reformimin e sistemit të apelimit administrativ dhe ngritjen e gjykatave administrative.

C. Reformat sektoriale[1]

Reformat sektoriale, krahas prioriteteve e objektivave sipas strategjive përkatëse, do t'i kushtojnë një vend të veçantë parandalimit e luftës kundër korrupsionit me ndërhyrje specifike sipas sektorit, kryesisht për disa sektorë prioritarë e të ndjeshëm.

1. Fuqizimi i kontrollit të brendshëm në sektorin publik

Fuqizimi i kontrollit të brendshëm në sektorin publik synon zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të pavarur, efektiv dhe që operon sipas standardeve ndërkombëtare; forcimin e sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit nëpërmjet rishikimit të ligjit për auditimin e brendshëm në sektorin publik dhe përafrimit me standardet ndërkombëtare, miratimit dhe zbatimit të manualit procedural për kontrollin e menaxhimit financiar, rishikimit të manualit procedural për kontrollin e brendshëm, forcimit të kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore, njohjes së praktikave ndërkombëtare të auditimit nëpërmjet përditësimit të njohurive, vendosjes së kritereve të certifikimit për pranimin në sektorin publik të auditeve. Gjithashtu, synohet miratimi dhe zbatimi i efektshëm i standardeve kontabël sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, institucionalizimi i publikimit të raporteve të kontrollit dhe i shkëmbimit të gjetjeve ndërmjet strukturave të kontrollit të brendshëm e të jashtëm.

2. Forcimi i standardeve në sektorin e biznesit

Përmirësimi e lehtësimi i klimës së biznesit do të ndiqet paralelisht me forcimin e standardeve

[1] Referenca të qarta për aspekte të caktuara të reformave sektoriale të papërfshira në këtë nënseksion jepen në strategjitë përkatëse ndërsketoriale a sektoriale që i detajojnë më tej ato.

në këtë sektor për t'i shërbyer më mirë e me efektivitet biznesit dhe mbrojtjes së interesave të tij.

Në këtë aspekt, rishikimi i kuadrit ligjor për urbanistikën (planifikimin hapësinor/urban), për shoqëritë tregtare duke vënë në zbatim standardet më të mira dhe duke rishikuar e forcuar sanksionet për profesionet kontabël, do të shoqërohen me ndërhyrje të rëndësishme institucionale për të formalizuar e standardizuar më tej marrëdhëniet e biznesit me administratën publike.

Hartimi dhe zbatimi i një plani për formalizimin e biznesit të vogël duke synuar mekanizma e masa konkrete si përdorimi kasave, vendosja e detyrueshme e sistemit të faturimit etj.

3. Forcimi i shërbimit civil

Forcimi e konsolidimi i shërbimit civil do të përqendrohet në disa drejtime prioritare, si:

- Forcimi statusit të nëpunesit civil dhe i garancive të sistemit të karrierës në administratën publike;
- Shtrirja e statusit të nëpunësit civil në pjesën më të madhe të organeve të administratës publike;
- Rritja e profesionalizmit të nëpunësve;
- Zbatimi i transparencës dhe parimit të meritës në rekrutimin në administratën publike;
- Forcimi i rregullave të posaçme të etikës dhe të parandalimit të konfliktit të interesave në strukturat e ndryshme të administratës publike;
- Shtrirja e sistemit të denoncimit, kontrollit/zbulimit dhe mbrojtjes me ligj, sipas modelit bashkëkohor të "whistleblowing";
- Rritja e interesit të punësimit në administratën publike (trajtimi financiar, strehimi...) dhe thithja e kapaciteteve brenda dhe jashtë vendit;
- Rishikimi i sistemit të pagave dhe shpërblimeve duke i harmonizuar me vlerësimin e performancës, shpërblimin sipas vendit të punës dhe kualifikimin shkencor;
- Forcimi i aftësive dhe kapaciteteve të administrimit, performancës dhe trajnimit të administratës publike në fushën e parandalimit dhe të luftës kundër korrupsionit;
- Forcimi i seriozitetit të reformës në administratën publike duke u përqendruar në vlerësimin e aftësive të individit, dhe në reformën funksionale për ndarjen e strukturës sipas funksioneve;
- Përmirësimi dhe motivimi i vlerësimit periodik të nëpunësve të administratës publike;
- Trajnimi i nëpunësve lidhur me fushat e sektorët e ndjeshëm problematikë (dogana, tatime, prokurime, ekspertët kontabël e kontabilistët..), me çështje të etikës e antikorrupsionit;
- Rritja e aksesit e publikimi i punësimeve/transferimeve/largimeve në administratën publike;
- Forcimi i mekanizmave të përgjegjesisë institucionale e individuale në politikën e administrimit të burimeve njerëzore.

4. Reformimi i sistemit të prokurimit publik

Konsolidimi i sistemit të prokurimit publik, në përputhje me standardet europiane, synon një sërë prioritetesh strategjike përsa i përket kuadrit rregullator, konsolidimit të ndjeshëm e maksimal të transparencës dhe konsolidimit të shërbimeve elektronike nëpërmjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit e komunikimit, fuqizimit të kapaciteteve të APP-së dhe autoriteteve kontraktore, institucionalizimit të trajnimit, fuqizimit të sistemeve të shkëmbimit të të dhënave dhe promovimit e zhvillimit të standardeve etike.

Priotetet kryesore do të jenë:

- Zhvillimi i kuadrit nënligjor dhe i dokumenteve standarde të prokurimit publik;
- Konsolidimi dhe përhapja e praktikës së prokurimit elektronik;
- Ngritja dhe konsolidimi i Avokatit të Prokurimeve Publike;
- Garantimi i shqyrtimit të pavarur të ankesave:
- Garantimi i transparencës maksimale të prokurimit publik dhe konsolidimi i shërbimeve elektronike;
- Fuqizimi Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Koncesioneve dhe specializimi i personelit të saj;
- Zhvillimi e fuqizimi i mekanizmave të përgjegjësisë institucionale për të dalluar, parandaluar e dënuar praktikat korruptive;
- Institucionalizimi i trajnimit periodik në të gjitha strukturat publike përkatëse;
- Funksionimi i sistemeve të shkëmbimit të të dhënave me sektorë të tjerë (*black list*);
- Nxitja e zhvillimi i kodeve të etikës në prokurimin publik;
- Zhvillimi i standardeve minimale të detyrueshme për çdo kontratë prokurimi publik;

- Forcimi i ndjekjes e mbikëqyrjes së zbatimit e cilësisë së shërbimit të kontratave të prokurimit publik.

5. Reforma në sistemin e shëndetësisë

Reformimi i përgjithshem i sistemit shëndetësor do të përqendrohet në mënyrë të veçantë në reduktimin e parandalimin e korrupsionit të gjerë që ka prekur këtë sektor të rëndësishëm. Reformat ligjore, institucionale e funksionale do të synojnë veçanërisht reduktimin e korrupsionit në të 3 tipet e marrëdhënieve që vendosen në këtë sektor (personel mjekësor-pacient, institucion shëndetësor — pagues dhe institucion shëndetësor-furnizues). Prioriteti parësor do të synojë standardizimin e prokurimit të barnave, pajisjeve e aparaturave mjekësore, investimeve në shërbimin shëndetësor e spitalor dhe kontraktimit të shërbimeve të tjera. Gjithashtu, një priotet tjetër strategjik është reduktimi i ndjeshëm i veprimtarive ekonomike informale nga operatorët e sistemit shëndetësor.

Në lidhje me prioritetin e parë, politikat strategjike që do të ndiqen janë:

- Rregullimi i promovimit në zgjedhjen e barnave e pajisjeve synon krahas përcaktimit të listave bazë (LB) në nivel vendi dhe nivel rajonal, kufizimin e ndikimit të grupeve të interesit dhe të diskrecionit të komisioneve përzgjedhëse, përcaktimi i kritereve e procedurave specifike standarde që promovojnë transparencë dhe përgjegjshmëri të procesit, forcim i rregullave etike në marrëdhëniet me shoqatat tregtare e profesionale, vendosje treguesish dhe kriteresh vlerësimi, institucionalizim i programeve të monitorimit e të transparencës që synojnë nxjerrjen e zgjedhjeve e të blerjeve të pazakonta në krahasim me nevojat, nxjerrja e të dhënave krahasuese e përmbledhëse dhe publikimi i informacionit për të rritur transparencën, nxitjen e motivimin.

- Për sa i përket prokurimit si proces, synohet rritja e kapaciteteve të administrimit të prokurimeve duke siguruar konkurrencë efektive, rritja e transparencës së procesit dhe publikimi i raporteve të kontrollit, rritja e përgjegjshmërisë së palëve kontraktuese dhe kufizimi i diskrecionit, publikimi i listave të zeza e të bardha të operatorëve.

- Për sa i përket shpërndarjes, reformimi tërësor i mekanizmave të magazinimit, inventarizimit, transportit, sistemeve të administrimit të burimeve, sistemit të administrimit financiar duke qartësuar kompetencat, përgjegjësitë, rritur përgjegjshmërinë dhe përmirësuar nxitjen e stimulimin.

- Konsolidimi i sistemit të regjistrimit të barnave, i shpërndarjes në sektorin shëndetësor publik dhe i kontrollit.

- Institucionalizimi i etiketimit të barnave

Në lidhje me prioritetin e dytë (pagesat informale dhe personeli), synohet:

- Përcaktimi një strategjie të qartë dhe me afatë për rritjen progresive të pagave në sistemin shëndetësor duke kombinuar pjesën e mbuluar nga Buxheti i Shtetit me pjesën që rrjedh nga burimet e siguruara nga vetë sistemi.

- Inkurajimi i alternativave private dhe promovimi i kontraktimit nga shteti për pagimin e furnizuesve privatë duke rregulluar konfliktet e interesit, devijimin e detyruar të pacientëve vetëm drejt shërbimeve privatë, devijimin e kërkesave të operatorëve furnizues etj.

- Zhvillimi i sistemit të administrimit të bazuar në performancë dhe i sistemit të pagesës së operatorëve.

- Rregullimi i çështjes së pagesave informale dhe institucionalizimi i pagimit të kostove reale të shërbimeve, përjashtuar ato të urgjencës apo një listë e shkurtër.

- Vendosja e lidhjes direkte me rimbursimin nga sigurimet shëndetësore çfarë do të detyrojë individët të sigurohen dhe do të rrisë kontributin.

- Transparenca në radhën e dhënies së shërbimeve, nëpërmjet garantimit të publikimit të radhës së dhënies së shërbimit në çdo mjedis trajtimi shëndetësor.

- Krijimi i sistemeve të pagesave që parandalojnë e shmangin kontaktet e drejtpëdrejta.

- Rritja e rolit të urdhrave profesionalë dhe komiteteve të komunitetit.

- Rritja dhe forcimi i sistemit informativ shëndetësor për të drejtat e detyrimet përkatëse në institucionet e kujdesit shëndetësor.

- Institucionalizimi i kartave raportuese të shërbimeve publike dhe kryqëzimi i rezultateve me statistikat zyrtare.

- Rishikimi i sistemit të ankesave të të sëmurëve.

- Analizimi dhe shpërndarja e rezultateve të sondazheve e studimeve (të tilla si: studimet e standardeve të jetesës, studimet e shpenzimeve publike, studimet e shpërndarjes sasiore të shërbimeve,

studimet demografike e shëndetësore etj.).

6. Reforma në sistemin e arsimit

Reduktimi i korrupsionit në sistemin arsimor do të përqendrohet në disa drejtime prioritare si:

- Rregullimi i administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor (përcaktimi i kritereve dhe procedurave standarde të qarta për konkurrimin, emërimin, promovimin, vlerësimin e nxitjen e performancës, dokumentimin, transparencën e publikimin);
- Konsolidimi i sistemit financiar në sistemin arsimor: forcimi i mekanizmave qendrorë e lokalë të kontrollit e auditit, zhvillimi i teknikave të auditimit në institucionet arsimore, përmirësimi i sistemit të koordinimit e komunikimit, rritja e rolit të komunitetit të prindërve, mësuesve, shoqatave studentore e shoqërisë civile për monitorimin e shpenzimeve e rezultateve në nivelin sektorial dhe institucional, veprimtarinë e autoriteteve të auditimit dhe zbatimin e rekomandimeve;
- Rritja e kapaciteteve prokuruese, përmirësimi i rregullave dhe procedurave të procesit të prokurimit, duke u fokusuar në përafrimin me praktikat ndërkombëtare në sistemin arsimor: promovimi i praktikave të përparuara në procesin e monitorimit, analizës dhe vlerësimit në fushën e planifikimit dhe realizimit, duke institucionalizuar, krahas sistemeve të kontrollit të brendshëm edhe sistemet e mekanizmat e jashtëm të vlerësimit të rezultateve, si dhe administrimit të ankesave;
- Rregullimi mbi baza të qarta i marrëdhënieve mësues-nxënës — Kodi i Mësimdhënies, parandalimi i konfliktit të interesave dhe përcaktimi i standardeve etike në arsim;
- Studimi i mundësisë së krijimit të Urdhrit të Mësuesit;
- Garantimi i regjistrimit të veprimtarive private të mësimdhënies nëpërmjet vetëdeklarimit të zyrtarëve publike
- Forcimi i inspektimit të cilësisë së shërbimeve në operatorët publikë e privatë të arsimit të lartë;
- Ngritja e sistemit të indeksimit dhe klasifikimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe të mesëm sipas cilësisë, specifikave e vlerave që ofrojnë;
- Garantimi i transparencës në shpërndarjen e subvencioneve për shkollimin dhe buxhetimin e arsimit arsimor në të gjitha nivelet;
- Konsolidimi e shtrirja e përvojës së maturës shtetërore në provimet dhe në pranimet e studentëve në arsimin e lartë; (konsolidimi i infrastrukturës teknike e njerëzore, i procedurave dhe transparencës për të siguruar cilësinë, efiçencën dhe integritetin e certifikimit të provimeve, korrigjimeve, rezutateve e pranimeve);
- Përfshirja në programet mësimore (shkollave, kurseve) të njohurive për çështjet e korrupsionit, etikës së sjelljes së zyrtarëve dhe funksionimin e institucioneve publike dhe jopublike, edukimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në luftën kundër korrupsionit;
- Zgjerimi i përfshirjes së komunitetit të nxënësve e studentëve dhe të komunitetit qytetar në politikëbërjen mbi baza transparente në fushën e arsimit.

7. Reformimi i sistemit të buxhetimit dhe të planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve

Në kuadër të reformimit të sistemit të buxhetimit dhe të planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, parandalimi i korrupsionit synon disa prioritete si thjeshtimi i sistemit të planifikimit e ekzekutimit të buxhetit nëpërmjet identifikimit dhe vendosjes së prioriteteve të qarta dhe institucionalizimit të parashikimit afatmesëm të buxhetit (3-vjeçar), garantimit të universalitetit të buxhetit e kufizimit në maksimum të spontanitetit e diskrecionit në buxhetim, forcimit të rolit të Kuvendit nëpërmjet pjesëmarrjes më të gjerë e me kompetencë në diskutimin, analizën, miratimin e mbikëqyrjen e zbatimit të buxhetit, vendosjes së një sistemi transparent, të përgjegjshëm e të orientuar të buxhetit. Gjithashtu, synohet konsolidimi i bashkëpunimit e konsultimit transparent me grupet e interesit për hartimin e buxheteve, veçanërisht tarifat për detyrimet doganore që janë shpesh të diktuara nga grupe apo individë biznesi të afërt me qeverinë; konsolidimi i informimit periodik dhe i përfshirjes së aktorëve të interesuar në fazat e ndryshme të planifikimit e ekzekutimit të buxhetit, konsolidimi i standardizuar i kontrollit të të ardhurave e shpenzimeve.

Në kuadër të sistemit të kontrollit të jashtëm, nevojitet dhe synohet qartësimi i rolit e përgjegjësive të kontrollit të jashtëm përtej konceptit të kontrollit të brendshëm, i përqendruar në kontrollin e performancës së përdorimit me efiçencë e ekonomicitet të burimeve publike, vlerësimi i sistemit të drejtimit, procedurave dhe rekomandime për përmirësimet e mangësitë në kuadrin ligjor e nënligjor.

8. Rritja e performancës dhe besueshmërisë së administratës doganore

- Sjellja e legjislacionit doganor në linjë me standardet komunitare për të qartësuar e përcaktuar saktë rregullat dhe procedurat doganore, në funksion të misionit primar të doganave për lehtësimin e tregtisë së ligjshme;

- Konsolidimi e modernizimi i procedurave për të rritur efiçencën e veprimtarisë, zbatimi i procedurave sipas parimeve të parashikueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe transparencës, rritja e ndjeshme e transparencës dhe publikimi i të gjithë informacionit për kuadrin ligjor, nënligjor, rregullator, procedurat e praktikat për të gjitha palët e interesuara, shtrirja e zbatimit të teknikave bashkëkohore të kontrollit fizik sipas parimeve të menaxhimit të riskut, shtrirja e përdorimit të teknologjisë së informacionit në të gjitha pikat e kalimit kufitar të Republikës së Shqipërisë dhe përmirësimi i sistemit kompjuterik për të qenë në gjendje të komunikojë *on-line* me agjenci të tjera qeveritare;

- Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe forcimi i kontrollit ad-posterioh me theks të veçantë luftën kundër trajtimeve preferenciale, favorizimeve dhe formave të tjera të shitjes së interesit publik në këmbim të bakshisheve e rryshfeteve;

- Forcimi i kontrollit të deklaratave të pasurisë të zyrtarëve doganorë dhe rritja e bashkëpunimit me agjencitë e tjera shtetërore që operojnë në këtë fushë;

- Krijimi i strukturave efektive, përmirësimi i administrimit të burimeve njerëzore dhe i kritereve të rekrutimit;

- Zbatimi i sistemit të rotacionit periodik dhe mbi bazë risku të personelit doganor;

- Rritja cilësore dhe institucionalizimi i trajnimit periodik për të gjithë të punësuarit e sistemit;

- Përmirësimi i aftësive manaxhuese në nivel dege, rajoni dhe në të gjitha divizionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;

- Rritja cilësore e bashkëpunimit efektiv me organet e tjera shtetërore e joshtetërore, si tatimet, bankat, sigurimet dhe organizatat e bashkimet e biznesit;

- Përmirësimi dhe sjellja në linjë me praktikën më të mirë të BE-së në lidhje me vlerësimin doganor, rregullat e origjinës, tarifat, procedurat, regjimet ekonomike etj.;

- Rritja e aksesit dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të tatimpaguesve që cenohen nga procedurat doganore; informatizimi i procedurës së marrjes së thirrjeve nga publiku, prezantimi i një procedure të re për hapjen, hetimin dhe mbylljen e rastit të denoncuar etj.;

- Përmirësimi dhe zbatimi efektiv i standardeve të etikës, shmangies së konfliktit të interesit dhe nepotizmit;

- Rritja e bashkëpunimit me prokurorinë, Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave dhe trupat e tjera të specializuara në ndjekjen dhe goditjen e krimit, korrupsionit, evazionit dhe kontrabandës.

9. Rritja e performancës dhe besueshmërisë së administratës tatimore;

- Orientimi i përmirësimit të administrimit tatimor drejt zbatimit rigoroz të ligjit dhe jo thjesht drejt realizimit të planit të realizimit të të ardhurave;

- Prezantimi i MIS-it dhe përfshirja në sistem e të gjitha degëve tatimore;

- Prezantimi i një sistemi modern vlerësimi dhe matja e performancës së punonjësve me tregues konkretë;

- Rishikimi i të gjitha rregullave e procedurave për t'i bërë ato më të qarta, më të thjeshta e më transparente në lidhje me përcaktimin e detyrimeve tatimore (kryesisht detyrimet që parapaguhen si tatim-fitimi etj.);

- Forcimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve për taksapaguesit dhe përmirësimi i aksesit në shërbime nëpërmjet thjeshtimit të procedurave, rritjes së transparencës, zgjerimit të informatizimit;

- Fillimi dhe përhapja e deklarimit on-line që nga selitë e tatimpaguesve;

- Kthimi i administratës tatimore në shërbim tatimor duke ofruar falas cilësi, thjeshtësi e shpejtësi në shërbimet për klientët e saj;

- Forcimi i sistemit të apelimit dhe garantimi i mbrojtjes së tatimpaguesve;

- Forcimi kontrollit të brendshëm;

- Rishikimi dhe përmirësimi i kodit të etikës së punonjësit tatimor;

- Rishikimi i pranisë gjeografike të administratës tatimore, prezantimi i linjave funksionale dhe rishikimi i rolit të policisë tatimore me tendencë kthimin e saj në departament të hetimit kriminal;

- Upgradimi i sistemit IT për të rritur efektivitetin e punës së administratës tatimore dhe

plotësimi me module të reja;

- Forcimi i bashkëpunimit me shoqatat e biznesit;
- Forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis sistemit tatimor, atij doganor dhe thesarit të shtetit.

10. Reforma në sektorin e transportit dhe telekomunikacionit

- Reforma e vetërregullimit në licencim, kolaudim dhe standardet e automjeteve;
- Liberalizimi i tregut të telefonisë celulare e fikse;
- Konsolidimi i mekanizmave të vetërregullimit të tregut sipas parimit të konkurrencës.

11. Reforma në fushën sociale

Në kuadër të realizimit të strategjive për punësimin e formimin profesional dhe mbrojtjen e sigurinë sociale, disa nga objektivat dhe politikat që kanë efekte në fushën e parandalimit të korrupsionit janë si më poshtë:

- Informatizimi i administrimit të informacionit në zyrat e punësimit, inspektoratet e punës dhe zyrat e shërbimit social, si dhe konsolidimi i bazave të të dhënave për tregun e punës dhe mbrojtjen e sigurinë sociale;
- Shpërndarja e ndihmës ekonomike nëpërmjet mekanizmit të palëve të treta (sistemi bankar, posta);
- Forcimi i transparencës në shpërndarjen e ndihmës ekonomike, rishikimi i kritereve dhe garantimi publikimit të listave, sigurimi i njohjes nga përfituesit të të drejtave të tyre në fushën e dhënies së shërbimeve sociale;
- Sigurimi i përditësimit periodik të informacionit lidhur me ndihmën ekonomike, paaftësinë e shërbimet socialë, si dhe i treguesve statistikorë;
- Forcimi i bashkëpunimit e bashkëveprimit ndërmjet ISSH, inspektorateve të punës, zyrave të punësimit dhe administratës tatimore;
- Forcimi inspektimit dhe vënia në funksionim e mundësisë së shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet sistemeve të ndryshme (regjistrimi i pasurive, inspektoratet e punës, administrata tatimore e doganore, qendra e regjistrimit të bizneseve etj.).

12. Reforma në fushën e kulturës, turizimit dhe sportit

- Përmirësimi i kuadrit ligjor e institucional për sponsorizimet e veprimtarive kulturore e artistike;
- Forcimi i administrimit të institucioneve kulturore e artistike;
- Rregullimi i funksionimit të operatorëve privatë dhe pjesëmarrjes e subvencionimit publik;
- Plotësimi i matrikulimit e katalogimit në Bazën Kombëtare të të Dhënave të veprave të trashëgimisë kulturore;
- Rregullimi ligjor për miradministrimin e kontrollin e lëvizjes së lirë të objekteve kulturore;
- Mbikëqyrja e kontrollit të tregjeve të paligjshme të objekteve kulturore dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar;
- Transformimi i klubeve sportive në shoqëri anonime;
- Garantimi i transparencës në sponsorizimin e aktiviteteve sportive për të mënjanuar evazionin fiskal;
- Rishikimi ligjor i përdorimit të të ardhurave që rrjedhin nga shitja e së drejtës televizive në veprimtaritë sportive dhe kontrolli i këtyre të ardhurave;
- Plotësimi i kuadrit ligjor dhe i procedurave rregullatore për nxitjen e investimeve në turizëm dhe fuqizimi i strukturave administrative për thithjen e fondeve nga donatorët për zhvillimin e turizmit;
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i respektimit të të drejtave të autorit, të të drejtave të artistëve interpretues dhe të të drejtave të shfrytëzimit të produkteve intelektuale;
- Garantimi i shpërblimit të produktit intelektual sipas vlerësimit profesional;
- Mbikëqyrja e rreptë për qarkullimin civil të mallrave që përbëjnë pronësi intelektuale në fushën e artit, kulturës dhe të shkencës.

13. Reforma e së drejtës së pronësisë

- Reformimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Forcimi dhe përmirësimi i ligjit;
- Forcimi dhe plotësimi i kuadrit nënligjor;
- Përmirësimi i statusit dhe trajtimit të punonjësve të ZRPP;

- Përfundimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

- Shtrirja e informatizimit të sistemit;

- Transparenca dhe integriteti në zbatimin e reformës së kthimit e kompensimit të pronave të paluajtshme;

- Transparenca dhe integriteti në zbatimin e reformës së legalizimit të pronave të paluajtshme dhe futja e tyre në qarkullimin ekonomik e civil.

14. Decentralizimi i shërbimeve publike dhe lufta kundër korrupsionit në nivel vendor

- Mbështetja e hartimit të planeve dhe programeve antikorrupsion në nivel vendor

- Nxitja e transparencës në menaxhimin e financave vendore duke motivuar përfshirjen e këshillave vendorë dhe kontrolleve vendore;

- Përmirësimi i cilësisë dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve publike duke motivuar përhapjen e shërbimeve elektronike;

- Rritja e aksesit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje nëpërmjet formave të konsultimit të vendimeve të rëndësishme;

- Konsolidimi i refomës urbanistike dhe sigurimi i mbështetjes për njësitë vendore për një zbatim rigoroz dhe efektiv të kuadrit ligjor të territorit;

- Konsolidimi i reformës së tokës;

- Forcimi i kontrollit dhe vetëkontrollit;

- Konsolidimi i transparencës dhe zgjerimi i informatizimit;

- Rritja e transparences së procesit të buxhetimit.

D. Konsolidimi i transparencës dhe integritetit në administratën publike

1. Transparenca dhe informimi i publikut

- Transparencë maksimale e proaktive e institucioneve publike nëpërmjet aksesit të lirë dhe të plotë në të dhënat mbi veprimtarinë e institucioneve publike si mjeti kryesor i mirëqeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit;

- Konsolidimi i strukturave të informimit të publikut në administratën publike (front office i back office);

- Zbatimi i rregulloreve në institucionet publike për zbatimin e së drejtës për informim;

- Respektim efikas i lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes së mendimit;

- Nxitja, konsolidimi dhe financimi i granteve për nisma që synojnë rritjen e transparencës dhe forcimin e "vëzhgimit qytetar e mediatik" mbi institucionet dhe zyrtarët.

2. Konsolidimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit

- Realizimi i E-Government në nivelin e qeverisjes qendrore;

- Realizimi i ofrimit të shërbimeve më të rëndësishme publike *on line*;

- Kompletimi i regjistrave të dixhitalizuar të gjendjes civile, të pasurive të paluajtshme, të tokës dhe të dokumenteve të identitetit të shtetasve;

- Krijimi, vënia në funksionim dhe bashkëveprimi i sistemeve të informacionit lidhur me hetimin e korrupsionit, deklaratat fiskale, vendimet gjyqësore, qarkullimin e njerëzve, sistemin e adresave etj;

- Ngritja e një rrjeti kombëtar me faqet e internetit të shkollave të mesme dhe universiteteve shqiptare dhe realizimi i një fushate ndërgjegjësuese *on line* për denoncimin e rasteve të korrupsionit dhe parandalimin e tij;

- Ndërtimi i një portali rinor për edukimin e të rinjve, ofrimin e shërbimeve *on line*, informimin për përmasat e korrupsionit dhe praktikat korruptive, promovimin e nismave në parandalimin e luftën kundër korrupsionit, ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet të rinjve shqiptarë e të huaj, promovimin e Shqipërisë, turizmit dhe kulturës kombëtare;

- Thjeshtimi e standardizimi i procedurave për ofrimin e shërbimeve publike dhe rritja e transparencës nëpërmjet aplikimeve elektronike nëpërmjet internetit;

- Vënia në funksionim dhe konsolidimi i sistemit *one-stop-shop* për ofrimin e licencave dhe regjistrin tregtar.

E. Përafrimi i legjislacionit në fushën e korrupsionit

1. Sigurimi i përputhshmërisë së kuadrit ligjor me konventat penale e civile kundër korrupsionit të Këshillit të Europës

- Ndryshime në Kodin Civil për të përshtatur standardet e Konventës Civile të KE-së

- Vendosja e përgjegjësisë civile që rrjedh nga veprimet korruptive

- Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile
- Lejimi i provës me dëshmitarë për veprimet korruptive
- Rishikim i ligjit "Për shoqëritë tregtare"
- Ndryshime në Kodin e Punës
- Përjashtimi nga masat disiplinore kur dyshimet për korrupsion nuk vërtetohen
- Ndryshime në ligjin "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore"
- Përcaktimi i përgjegjësisë së administratës shtetërore për shkak të veprimeve korruptive
- Ndryshime në ligjin "Statusi i nëpunësit civil"
- Përjashtimi nga masat disiplinore kur dyshimet për korrupsion nuk vërtetohen
- Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale
- Shtimi i përdorimit të teknikave të posaçme të hetimit për vepra penale korruptive, si livrimet e mbikëqyrura, mbikëqyrja elektronike ose veprimet e infiltrimit
- Ndryshime në Kodin e Procedurave Administrative
- Përgjegjësia e administratës publike dhe punonjësve të saj për dëmet që iu shkaktohen personave privatë nëpërmjet veprimeve korruptive
- Ndryshime në Kodin Penal. Parashikimi si vepër penale:
- korrupsioni aktiv i agjentëve publikë të huaj dhe funksionarëve të organizatave ndërkombëtare publike për sigurimin e një tenderi në fushën e tregtisë ndërkombëtare,
- fshehja e mbajtja e pasurive të paligjshme,
- pengimi i drejtësisë, përfshirë pengimin e funksionimit të institucioneve gjyqësore të një shteti tjetër,
- korrupsioni pasiv i agjentëve publikë të huaj ose funksionarëve të organizatave ndërkombëtare publike,
- pasurimi i paligjshëm,
- keqadministrimi, vjedhja ose përfitimi i paligjshëm i pasurisë në sektorin privat,

- Lejimi, bllokimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të krimit, me mundësinë, por jo detyrimin e përmbysjes së barrës së provës, parashikimi i pasojave të korrupsionit duke i bërë të pavlefshme prokurimet ose kontratat, heqja e pengesave që mund të rezultojnë nga legjislacioni për sekretin bankar.

2. Vënia në zbatim e detyrimeve të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit.

Hartimi dhe vënia në zbatim të planit dhe kalendarit të nismave e masave të duhura për përafrimin me standardet e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit.

3. Përmirësimi i kodeve për të shmangur problemet e ndeshura dhe plotësuar mangësitë, me qëllim që vendimmarrja e gjykatave të jetë e parashikueshme.

F. Edukimi dhe pjesëmarrja e qëndrueshme e publikut

- Zbatimi rigoroz i kuadrit ligjor, institucional e rregullator për denoncimin e korrupsionit (linjat e posaçme të telefonit);
- Vendosja dhe konsolidimi i përvojës së denoncimeve;
- Edukimi ligjor dhe antikorrupsion i qytetarëve e veçanërisht i brezit të ri;
- Ndërmarrja e mbështjetja e nismave të shoqërisë civile, universiteteve e komunitetit të juristëve për edukim masiv ligjor të të gjitha shtresave shoqërore;
- Financimi nga Buxheti i Shtetit i nismave të shoqërisë civile dhe medias për monitorimin e funksionimit të institucioneve, si dhe të nismave a projekteve që lidhen me parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e transparencës (si vëzhgime të pavarura për perceptimin e korrupsionit, studime a analiza të dinamikave të fenomenit dhe/ose të impaktit të përpjekjeve antikorrupsion, projekte që lidhen me forcimin e transparencës etj.);
- Shtrirja e edukimit ligjor në sistemin arsimor;
- Fushatë sensibilizuese në vazhdim për të luftuar korrupsionin;
- Edukim, ndërgjegjësim e sensibilizim proaktiv e i vazhdueshëm për të rritur mbështetjen e publikut në luftën kundër korrupsionit (publikime, fushata, sondazhe, opinione, debate publike, monitorim nga shoqëria civile);
- Kontraktimi shërbimeve studimore e analitike në fushën e korrupsionit pranë OJF-ve të specializuara;

- Promovimi i raporteve nga organizata të pavarura.

II. HETIMI DHE DËNIMI I KORRUPSIONIT

A. Konsolidimi i hetimit dhe eficencës së ndjekjes penale, rritja e shpejtësisë së ndjekjes penale dhe gjykimit

1. Konsolidimi i hetimit

Zbatimi i efektshëm dhe përmirësimi i mekanizmave dhe mjeteve për hetimin e akteve të korrupsionit, rritja e mekanizmave të kontrollit e të vetëkontrollit të strukturave të policisë sipas kritereve të vlerësimit të riskut dhe të indikatorëve metodologjikë që favorizojnë korrupsionin, forcimi e zgjerimi i informatizimit, konsolidimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit, forcimi i kapaciteteve dhe burimeve për përdorimin e efektshëm të teknikave të posaçme të hetimit, konsolidimi i procedurave e standardeve për rekrutimin, transferimin, trajnimin, specializimin, standardet etike e profesionale e motivimin financiar të punonjësve të policisë (veçanërisht të strukturave të hetimit), ngritja e kritereve profesionale, konsolidimi i mekanizmave të bashkëpunimit me organet e ndjekjes penale dhe përgjithësisht me agjencitë e tjera të forcimit të ligjit.

2. Efiçenca e ndjekjes penale

Konsolidimi i sistemit të hetimit dhe rritja e ndjeshme e shpejtësisë dhe e efiçencës së ndjekjes penale do të përqendrohen në përmirësimin e mekanizmave e procedurave për të rritur efiçencën e ndjekjes penale, rritjen e pavarësisë së prokurorëve, ristrukturimin e forcimin e kapaciteteve në sistemin e prokurorisë, rishikimin e zbatimin e kodit të etikës së prokurorëve, konsolidimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorisë e policisë gjyqësore, reformimin e thellë e të qëndrueshëm të strukturave të policisë, vendosjen e sistemit të administrimit të çështjeve sipas standardeve më të mira, vendosjen e garantimin e funksionimit të rregullit të ndarjes me short të çështjeve, garantimin e statistikave periodike të ecurisë së ndjekjes penale, rishikimin e mekanizmave që sigurojnë transparencën dhe marrëdhëniet me publikun.

B. Rritja e integritetit dhe rezistencës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë

Disa nga problemet më shqetësuese në sistemin e drejtësisë lidhen me transparencën e ulët të proceseve penale dhe civile të drejtësisë, çka ka sjellë shkallë të ulët besueshmërie të publikut në sistemin gjyqësor; mungesën e transparencës dhe procedurat jo objektive të emërimit të gjyqtarëve e prokurorëve; mangësitë në statusin, pavarësinë dhe mbrojtjen e posaçme që u sigurohet gjyqtarëve; mangësitë infrastrukturore në gjykata, prokurori, burgje, dhoma paraburgimi etj.; mungesa e statusit dhe pagat e ulëta të stafit administrativ të gjykatave; shkalla jo e kënaqshme e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Prioriteti kryesor në këtë sistem është rritja e shkallës së besueshmërisë së publikut te drejtësia nëpërmjet krijimit të një sistemi gjyqësor të pavarur, transparent, të përgjegjshëm dhe efiçent.

1. Sistemi gjyqësor

- Fuqizimi i institucioneve të vetëkontrollit dhe administrimit të sistemit të drejtësisë;
- Analiza, vlerësimi dhe përmirësimi i legjislacionit dhe strukturave mbi funksionimin e drejtësisë, për qartësimin e kompetencave për kontrollin e brendshëm gjyqësor dhe detyrat e inspektorateve;
- Forcimi i inspektorateve dhe mbështetja me bazën e duhur ligjore për matjen e vlerësimin e performancës së gjyqtarëve;
- Sigurimi i publikimit të raportëve të inspektorateve;
- Standardizimi i dosjes gjyqësore (civile e penale);
- Konsolidimi i sistemit të vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve;
- Përcaktimi i kritereve objektive e transparente dhe rishikimi i procedurave të emërimit të gjyqtarëve;
- Rritja e profesionalizmit të gjyqtarëve;
- Përcaktimi i statusit të administratës gjyqësore;
- Nxitja e krijimit të formave të tjera alternative të gjykimit si arbitrazhi dhe ndërmjetësimi;
- Trajnimi dhe kualifikimi i grupit të mediatorëve që do të merren me ndërmjetësimin në çështjet penale, civile, familjare dhe administrative;
- Ngritja dhe konsolidimi i Gjykatës Administrative;
- Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në gjykata dhe forcimi i miradministrimit të drejtësisë;
- Transpozimi i standardeve antikorrupsion të BE-së, OKB-së, KE-së, OECD-së lidhur me

regjimin e imuniteteve;

- Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar me qëllim shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare me vendet e Bashkimit Europian në luftë kundër korrupsionit. Në këtë kuadër, trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve për njohjen e formave të reja të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar;
- Ngritja e një zyre pune të veçantë për kontakte me rrjete gjyqësore europiane si EUROJUST, EUROPEAN JUDICIAL NETWORK (EJN) dhe OLAF —Zyra Europiane Kundër Mashtrimit, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave gjyqësore ndërkombëtare në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Hartimi i një plani veprimi për publikimin e vendimeve gjyqësore;
- Publikimi i plotë i vendimeve gjyqësore;
- Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore dhe përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe paraburgimit në funksion të transparencës së kontrollit, drejtimit dhe komunikimit me publikun dhe institucionet jashtë burgut;
- Zgjerimi i automatizimit të sistemit të administrimit të çështjeve në gjykatat e apelit dhe të shkallës së parë;
- Zbatimi i një sistemi të ri kalendarimi për shkurtimin e kohës së trajtimit të çështjeve;
- Prodhimi i statistikave të sakta;
- Gjenerimi automatik i raporteve të performancës së çdo gjykate dhe çështjeve të mbetura apo në proces;

- Kryerja e një studimi fizibiliteti dhe marrja e masave ligjore dhe institucionale për përgjegjësinë e magjistratëve ndaj palëve të treta;
- Zhvillimi i një sistemi IT në gjyqësor, në përbërje të të cilit të jenë e-justice, sistemi i integruar i informacionit për luftën kundër krimit, menaxhimit të çështjeve, burgjeve dhe paraburgimit;
- Hartimi i një studimi fizibiliteti dhe rekomandimeve për masat e nevojshme ligjore dhe institucionale për shkurtimin e afateve të proceseve gjyqësore dhe reduktimin e numrit të çështjeve të pazgjidhura;
- Ngritja dhe funksionimi i një njësie të veçantë që do të merret me arkivimin e dokumenteve elektronike në sektorin gjyqësor (me dokumente elektronike do të kuptohen tekste, materiale video dhe audio, në forme dixhitale) e cila do t'i shërbejë publikut të interesuar në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës për komunikim të drejtpërdrejtë në rrugë elektronike;
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme (ambiente) për organizimin e videokonferencave, si edhe trajnimi i personave përkatës;
- Bashkëpunim intensiv ndërmjet institucioneve të drejtësisë në funksion të luftës kundër korrupsionit.

2. Reformimi e konsolidimi i sistemit të përmbarimit

- Ristrukturimi e forcimi i sistemit të përmbarimit
- Krijimi dhe zbatimi i praktikave të unifikuara dhe përmirësimi i legjislacionit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në nivelet mesatare të BE-së;
- Unifikimi i procesit të administrimit të ekzekutimit;
- Licencimi i operatorëve privatë në këtë fushë;
- Konsiderimi i mundësisë së kthimit të shërbimit të përmbarimit në ent të pavarur, me autoritetin e pavarësinë e duhur për të rritur efektivitetin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- Hartimi dhe zbatimi i një programi trajnimi fillestar dhe vazhdues për përmbaruesit (afatmesme);
- Krijimi i një rrjeti të brendshëm dixhital për gjithë sistemin e shërbimit përmbarimor (afatmesme);
- Ekzekutimi i përgjegjshëm i vendimeve gjyqësore;
- Ristrukturimi e forcimi i kapaciteteve në institucionin e akuzës;
- Reformimi i sistemit të noterisë.

C. Forcimi i mjeteve administrative në luftën kundër korrupsionit

Prioritetet dhe objektivat që lidhen me parandalimin e shmangien e konfliktit të interesave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes publike, konsolidimin e sistemeve të kontrollit e të auditit, konsolidimin e sistemit të denoncimit, kontrollit, zbulimit dhe mbrojtjes me ligj sipas modelit të

"*whistleblowing*" janë drejtime dhe mekanizma të rëndësishëm administrativë që ndihmojnë hetimin dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit.

Forcimi i mjeteve administrative do të synojë vendosjen e sistemit ligjor, institucional dhe edukues për të promovuar krahas drejtimit penal, mjetet e përgjegjësisë administrative dhe civile për shkak të veprimeve korruptive.

Forcimi i mjeteve administrative do të synojë edhe bashkëpunimin e bashkëveprimin më efektiv ndërmjet organeve të administratës publike dhe organeve të specializuara të ndjekjes penale.

D. Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e korrupsionit

Në këtë drejtim, synohet:

- forcimi e nxitja e pjesëmarrjes së publikut në denoncimin e rasteve të korrupsionit jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat;

- garantimi i orientimit efikas të publikut në denoncimin e korrupsionit nëpërmjet infrastrukturës së duhur, respektimit të hierarkisë së përgjegjësisë e të autoritetit, administrimit të përgjegjshëm të heshtjeve, informimit e këshillit, publikimit e transparencës periodike;

- kanalizimi i energjive, përpjekjeve e informacionit nëpërmjet një rrjeti të mirëstrukturuar, efikas dhe operacional, që garanton shpejtësi e efikasitet në trajtimin e heshtjeve dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve përgjegjës.

III. KONSOLIDIMI I BASHKËPUNIMIT DHE BASHKËRENDIMIT TË BRENDSHËM DHE NDËRKOMBËTAR

A. Konsolidimi i mekanizmave në bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit

Konsolidimi i mekanizmave e mjeteve dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit është i një rëndësie të veçantë për parandalimin e efektshëm dhe arritjen e rezultateve në luftën kundër korrupsionit.

Në fusha të ndjeshme dhe që kërkojnë ekspertizë (aspektet e krimit ekonomik dhe pastrimi i parave), synohet forcimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës me organet e policisë e të ndjekjes penale dhe ofrimi i ekspertizës së duhur në fushat specifike e me risk të ndjeshëm,

B. Konsolidimi i mekanizmave të qëndrueshëm për shkëmbimin periodik të informacionit

Shkëmbimi i informacionit, jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit synon:

- Shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit e përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë;

- Shtrirjen e konsolidimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit për të rritur efikasitetin e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit;

- Hartimin, përpunimin dhe publikimin e statistikave periodike të konsoliduara në lidhje me korrupsionin të të gjitha institucioneve shtetërore përkatëse në buletine periodike.

C. Zbatimi i efektshëm i instrumenteve antikorrupsion rajonale e ndërkombëtare

- Prania dhe roli aktiv në nismat dhe angazhimet ndërkombëtare që lidhen me luftën kundër korrupsionit;

- Zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë dhe të projekteve të asistencës që lidhen me luftën kundër korrupsionit;

- Promovimi i praktikave të mira antikorrupsion dhe i përpjekjeve të autoriteteve shqiptare në këtë fushë në mënyrë periodike nëpërmjet raportimeve, publikimeve dhe rolit proaktiv të ambasadave.

KREU 4
LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Zbatimi i kësaj strategjie do të mbështetet në tregues, kritere llogaridhënie, monitorimi dhe vlerësimi standarde të vendosura sipas sistemit të planifikimit të integruar, duke u përqendruar te:

- Monitorimi sipas treguesve të identifikuar në kuadër të planit monitorues ministerial të krijuar në kuadër të sistemit të planifikimit të integruar;

- Treguesit e matshëm në rezultate e në përputhje me prioritetet e qëllimet strategjike;

- Përgjegjësitë përkatëse në nivel institucional e ndërinstitucional;

- Intervali, mekanizmat e forma e raportimit;

- Publikimi periodik i rezultateve;

- Modalitetet e pjesëmarrjes e këshillimit me aktorët e interesuar;
- Rishikimi i aspekteve të caktuara të strategjisë;
- Forcimi dhe konsolidimi i një rrjeti organizatash të shoqërisë civile në monitorimin e vazhdueshëm të fenomeneve korruptive. Për këtë qëllim qeveria do t'i financojë këto organizata dhe veprimtarinë e tyre duke repsektuar plotësisht pavarësinë e tyre.

Zbatimi i strategjisë nga aktorët përgjegjës e bashkëpunues mbështetet në planin e veprimit, pjesë e planit të integruar ministeria, e cila shpallet edhe si aneks këtij plani. Plani i veprimit hartohet sipas modelit bashkëlidhur.

Grupi Ndërministror (GN) që bashkërendoi hartimin e strategjisë bashkërendon punën për mbikëqyrjen/monitorimin dhe raportimin e zbatimit të strategjisë. Si rregull raportimi është vjetor, por GN mund të përgatisë edhe raporte të ndërmjetme.

Duke ndjekur zbatimin e strategjisë, por edhe dinamikat e përhapjes e zhvillimit të fenomenti të korrupsionit, GN përpunon rekomandimet dhe zhvillon draftin për përditësimin e strategjisë çdo vit.

Plani i veprimit (Model)

Nr.	Objektivat	Masat	Institucionet përgjegjëse/bashkëpunuese	Afati i realizimit	Burimet e zbatimit[2]	Treguesit monitorues[3]
1.	Këtu vendoset objektivi siç është përshkruar në strategji duke dhënë referencë të qartë, kreun, titullin dhe nëntitullin ku është listuar ose shprehur objektivi	Përshkruhen shkurt masat që parashikohen të ndërmerren për zbatimin e objektivit për vitin në vijim (Aneksi i PIM)	Ministria/agjencia e varësia, drejtoritë përkatëse		Burimet e veta, kontribute nga partnerë të tjerë	
2.						
3.						
4.						
…	…	…	…	…	…	…

VENDIM
Nr.1562, datë 26.11.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.108, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA FUSHË-KRUJË, TË QARKUT TË DURRËSIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.108, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 6 (gjashtë), e që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Fushë-Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

[2] Burimet njerëzore financiare, nevoja për asistecë/ekspertizë, bashkëpunim me aktorë/faktorë të tjerë, biznesi, shoqëria civile, mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë etj. Nevojitet parashikimi në buxhet i drejtimeve të caktuara dhe buxhetimi parashikues i nevojave për asistencë e mbështetje financiare për drejtime të paparashikuaara në planet buxhetore.

[3] Institucionet përgjegjëse e bashkëpunuese detyrohen t'i konkretizojnë objektivat e prioritete në plane konkrete, duke identifikuar treguesit më gjerësisht të përdorur të monitorimit të zbatimit dhe të raportimit të progresit periodik. Treguesit e monitorimit janë specifikë në kuadër të kësaj strategjie dhe monitorimi e ndjekja sipas intitucioneve dhe në shkallë të përgjithshme bëhet sipas këtyre treguesve. Treguesit e monitorimit antikorrupsion duhet të jenë të saktë, konkretë, të matshëm, cilësorë e sasiorë.

FORMULAR PËR NJË NDRYSHIM NË TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.108, datë 3.2.2008
(sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Bashkia: Fushë-Krujë											
Nr. rendor	Nr.i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (PP shtrirja gjeografike) PPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Sipërfaqja që do të hiqet	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi i juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	285	Krastë Krujë (Ek.P)	hpërdht	5	Pyll prodhues	8.00	8	Dru zjarri	MMPAU (DPPK)	DSHP	Hiqet e gjithë sipërfaqja
2	286	Krastë Krujë (Ek.P)	Faqe Macaline	6	Pyll prodhues	18.00	18	Dru zjarri	MMPAU (DPPK	DSHP	Hiqet e gjithë sipërfaqja
3	287	Krastë Krujë (Ek.P)	Dushku i Kishës	7	Pyll prodhues	15.00	9.25	Dru zjarri	MMPAU (DPPK	DSHP	I mbetet 5.75 ha bashkisë
4	291	Krastë Krujë (Ek.P)	Faqe e proit të Lanë	11	Pyll prodhues	4.00	2	Dru zjarri	MMPAU (DPPK	DSHP	I mbetet 2 ha bashkisë
5	300	Krastë Krujë (Ek.P)	Pylli Sallakëv	20	Pyll prodhues	20.00	1.93	Dru zjarri	MMPAU (DPPK	DSHP	I mbeten bashkisë 18.07 ha
6	301	Krastë Krujë (Ek.P)	Faqe e prroit Myh	21	Pyll prodhues	6.00	6	Dru zjarri	MMPAU (DPPK	DSHP	Hiqet e gjithë sipërfaqja

VENDIM
Nr.1563, datë 26.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KAVAJË, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Kavajë, të qarkut të Tiranës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Kavajë — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1,2,10,19,20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
113-117,119,121-126	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
156	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
128-151	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
320-322	Varrezat publike	Në pronësi
385,386,388,389,392	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
323-366,367-384,387,390,391,393,394,395-689	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
33	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
159-176,178-192	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
35-49	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
243,245	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
239,244	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
308	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi

VENDIM
Nr.1564, datë 26.11.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.202, DATË 21.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA THUMANË, TË QARKUT TË DURRËSIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.202, datë 21.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 2 (dy), e që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Thumanë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR NJË NDRYSHIM NË TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.202, datë 21.2.2008
(sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Komuna: Thumanë											
Nr. rendor	Nr.i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore EPK	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja e parcelës në ha	Sipërfaqja që do të hiqet	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	292	Krastë Krujë (Ek.P)	Bokë Kuqe sheshet	11	pyll prodhues	25	12	l punimi+dru zjarri	mmpau (dppk)	dshp	I mbeten komunës 13 ha
2	293	Krastë Krujë (Ek.P)	Faqe Grykë Dardhe	12	pyll prodhues	4.00	4	l punimi+dru zjarri	mmpau (dppk	dshp	

VENDIM
Nr.1565, datë 26.11.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.107, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, BASHKIA KRUJË, TË QARKUT TË DURRËSIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.107, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 2 (dy), e që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR NJË NDRYSHIM NË TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
Sipas vendimit të Këshilli të Ministrave nr.107, datë 3.2.2008
(sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Bashkia: Krujë											
Nr. rendor	Nr.i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja e parcelës	Sipërfaqja që do të pakësohet	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi i juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	101	Krastë Krujë (Ek.P)	Kodër Kallamishte	5	Pyll prodhues	47	40.8	Dru zjarri	mmpau (dppk)	dshp	I mbetet bashkisë 6.2 ha
2	113	Krastë Krujë (Ek.P)	bokë kuqe sheshet	9	Pyll prodhues	25.00	25	Dru zjarri	mmpau (dppk	dshp	

VENDIM
Nr.1567, datë 26.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS NIKËL, TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Nikël të qarkut të Durrësit, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Nikël, të qarkut të Durrësit, miratuar me vendimin nr.812, datë 29.11.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Nikël, të qarkut të Durrësit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Nikël për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Nikël — Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
72-80	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
68-71	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
58	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
59-67	Varrezat publike	Në pronësi
21-57	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
229-460,465-519	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
1-8,10	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
186-204	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
209 (vetëm kanalet e treta),214,220,224,228	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 19.12.2008
Doli nga shtypi më 22.12.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë